EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5693
E hënë, 4 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Koha e ribërjes së Shqipërisë

FAQE 7

Nga: Ismet HAJRULLAHU

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ZENUN PAJAZITI

FAQE 4-5

Brenda këtyre ditëve do të gjendet zgjidhja për taksën

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se partnerët e koalicionit qeverisës, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, do ta gjejnë zgjidhjen e duhur për çështjen e taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se taksa nuk do të paraqesë problem për funksionimin e koalicionit PAN dhe, sipas tij, nuk do të ketë luhatje në këtë drejtim. Pajaziti ka thënë se cilido që të jetë fati i taksës, ajo e ka arritur efektin e vet dhe nuk do të ketë luhatje të partneritetit me ShBA-në. Sa i perkat kërkesës për zgjedhje të reja, Pajaziti ka thënë se partitë opozitare nuk duhet të bëjnë fushata populiste, por pozitë dhe opozitë duhet të fokusohen në momentumin për zgjidhjen përfundimtare me Serbinë

LDK-ja dhe LV-ja kundër Ligjit për dialogun

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) sërish kanë refuzuar ofertën e pushtetit për t'u bërë pjesë e dialogut me Serbinë. Këto dy subjekte opozitare, edhe pas një debati të gjatë parlamentar, kanë votuar kundër Ligjit për delegacionin e Kosovës në dialogun me Serbinë të cilin Kuvendi e ka votuar me 61 vota. Sipas tyre, ky ligj nuk e kufizon presidentin e vendit dhe idetë e tij në këtë proces

FAQE 3

Kalon buxheti, 2 miliardë e 370 milionë euro për vitin 2019

FAQE 7

AKTUALE

NGRICA NË QEVERINË E KOSOVËS

F. 11

Bedri ISLAMI

AUSTRIA E NDIHMOI SHKOLLIMIN, SHKENCËN DHE KULTURËN SHQIPTARE DHE PAVARËSISË SHQIPTARE

F. 16-17

Mr. Sci. Hazir MEHMETI, Vjenë

SOT FILLON MËSIMI NË TË GJITHA SHKOLLAT

F. 5

PDK-ja KA PËRMBYLLUR ZGJEDHJET NË 420 NËNDEGË

F. 6

EKONOMI

'TREPÇA' BËHET ME STATUT

F. 6

LEKAJ: 298 MILIONË EURO JANË NDARË PËR PROJEKTE NË KOMUNAT E KOSOVËS

F. 6

SPORT

JANUZI, LOJTARI MË I PAGUAR NË KOSOVË

F. 18

ISTOGU BALLËHAPUR ELIMINOHET NGA GARAT EVROPIANE

F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht – Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Gruevski: U largova për në Hungari pasi më kërcënuan me vdekje

SHKUP, 3 SHKURT - Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikola Gruevski, thotë se u largua për në Hungari për ta shmangur dënimin prej dy vjetësh burgim pasi ai pranoi kërcënime se do të vritej. Në intervistën e parë që prej se ka ikur nga shteti, Gruevski tha se ai fillimisht kishte pasur për qëllim që të shkonte në burg për të vuajtur dënimin, pavarësisht se ai dënimin ndaj tij e quajti "pa bazë ligjore". "Por, pranova informacione se dikush po planifikonte të më likuidonte në burg. Prandaj, ndryshova vendimin tim", tha Gruevski.

Gruevski tha se ka pranuar informacione "nga njerëz brenda burgut që kanë qenë mirë të informuar" se është planifikuar një atentat ndaj tij. "Nuk mund ta them publikisht se kush qëndron pas këtij komploti sepse nuk mund të ofroja prova për këtë gjë në atë moment. Prandaj, vendosa të largohesha nga Maqedonia", tha ai.

Gruevski edhe më herët ka deklaruar se ka pranuar kërcënime me vdekje në Maqedoni, një akuzë për të cilën, Qeveria e kryeministrit Zoran Zaev ka shprehur skepticizëm, duke hedhur poshtë se ish-kryeministri Gruevski ka qenë viktimë e ndjekjes politike.

Mike Pompeo falënderon Bushatin

> "Qeveria e ShBA-së është veçanërisht mirënjohëse për angazhimin e Shqipërisë për ta promovuar demokracinë, stabilitetin dhe sigurinë, si një aleat i përkushtuar i NATO-s dhe një partner i ngushtë në koalicionin global për ta mposhtur ISIS-in", thuhet në mesazhin e Sekretarit amerikan të Shtetit, drejtuar Bushatit

TIRANË, 3 SHKURT - Gjatë ditëve të fundit si ministër i Jashtëm në detyrë, ish-kryediplomati Ditmir Bushati ka marrë letra falënderimi nga homologët e vet të huaj, veçanërisht ata të partneritetit strategjik me Shqipërinë.

Përmendim këtu sekretarin amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, ministrin e Jashtëm të Italisë, Enzo Moavero Milanesi, atë turk Mevlut Cavusoglu, por edhe sekretarin e jashtëm britanik Alan Duncan. "Unë jam plotësisht dakord me vlerësimin tuaj të partneritetit strategjik të suksesshëm mes dy vendeve tona, që ju ndihmuat ta forconi gjatë qëndrimit tuaj si ministër i Jashtëm. Në 27 vjetët e fundit Shqipëria ka qenë një aleate dhe një mike e patundur e Shteteve të Bashkuara. Qeveria ime është veçanërisht mirënjohëse për angazhimin e Shqipërisë për ta promovuar demokracinë, stabilitetin dhe sigurinë, si një aleat i përkushtuar i NATO-s dhe një partner i ngushtë në koalicionin global për ta mposhtur ISIS-in. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë pranë Shqipërisë, ndërsa përparon në rrugën e saj të drejtë të anëtarësimit në BE. Ju uroj gjithë të mirat në vijim të punës suaj si anëtar i Parlamentit. Ju falënderojmë për punën që po bëni në Parlament për ta siguruar përparimin demokratik dhe ekonomik të Shqipërisë", thuhet në mesazhin e sekretarit amerikan të Shtetit drejtuar Bushatit.

Edhe britaniku Alan Duncan ka vlerësuar angazhimin e ish-ministrit, ndërsa ka veçuar reagimin e shpejtë dhe në një zë me aleatët perëndimorë, në lidhje me dëbimin e diplomatëve rusë pas sulmit në Salisbury, sikurse edhe angazhimin dhe rolin e Shqipërisë në kuadër të procesit të Berlinit. "Faleminderit për bashkëpunimin e ngushtë që ne patëm gjatë kohës suaj si ministër i Jashtëm. Vendet tona bashkëpunojnë në një gamë të gjerë çështjesh të politikës së jashtme, e unë personalisht jam shumë mirënjohës për veprimet që morët si pjesë e reagimit të bashkësisë ndërkombëtare ndaj agresionit të Rusisë në Salisbury. Ishte kënaqësi të punoja me ju dhe ju uroj shumë suksese në përpjekjet tuaja të ardhshme", shkruan ministri britanik për Evropën, Alan Duncan.

Nuk kishin si të mungonin falënderimet nga dy vende mike të Shqipërisë, sikurse janë Italia dhe Turqia, me të cilat vendi ynë ka edhe volumin më të madh tregtar. Duke i cilësuar të shkëlqyera marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Italisë, ministri i Jashtëm Enzo Moavero Milanesi i ka shprehur mirënjohjen Bushatit, për rolin e tij në rritjen cilësore të këtij bashkëpunimi. "Dëshiroj t'i shpreh falënderimet e mia më të ndjera për bashkëpunimin e frytshëm të ndërtuar gjatë këtyre muajve. Sinergjitë e maturuara në fusha të ndryshme; midis të cilave për nga rëndësia e tyre kujtoj impenjimin e përbashkët në rrugën e integrimit evropian të Shqipërisë, sikurse edhe bashkëpunimin në kuadër të pjesëmarrjes së përbashkët në OSBE; do të jenë një themel i fortë për të vijuar në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Këto marrëdhënie, tashmë të shkëlqyera, patjetër që kanë regjistruar një rritje të mëtejshme cilësore gjatë mandatit tuaj", thekson Enzo Moavero Milanesi.

Ndërsa ish-homologu turk Mevlut Cavusoglu e falënderon për bashkëpunimin dhe konsolidimin e partneritetit strategjik mes dy vendeve. "Dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të sinqerta për bashkëpunimin tuaj, gjatë qëndrimit tuaj si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë. Dua të ritheksoj mbështetjen tonë për kandidaturën e Shqipërisë, si një anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së në vitin 2022-2023", shkruan Cavusoglu në letrën dërguar Bushatit.

Meta kërkon anulimin e projektit për 'Unazën e Re'

TIRANË, 3 SHKURT - Presidenti Ilir Meta priti një përfaqësi të banorëve të "Unazës së Re" që kundërshtojnë projektin e zgjerimit të saj dhe më pas doli me një qëndrim publik, duke i kërkuar Qeverisë ta anulojë projektin. "Presidenti i Republikës, në vlerësim të gjendjes së paligjshmërisë ekstreme të konstatuar nga keqfunksionimi i institucioneve të administratës shtetërore dhe të situatës së krijuar, vlerëson se kjo çështje mund dhe duhet të marrë një zgjidhje përfundimtare. Për këtë është e domosdoshme që qeveria të tregojë vullnetin politik dhe të anulojë menjëherë projektin. Pas anulimit të plotë të projektit ekzistues të nisin procedurat me garë të hapur për të realizuar një projekt të ri, i cili do të duhet të ofrojë zgjidhjen më të mirë teknike për zhvillimin urban të Tiranës", thuhet në njoftimin e Presidencës.

Presidenti shpjegon edhe pse nuk e bind vendimmarrja e Qeverisë dhe ARRSH-së për të rihapur procesin e tenderimit. "Aktualisht, organi i Prokurorisë është duke kryer hetime në këtë çështje, dhe nga ky hetim mund të zbulohen fakte dhe rrethana të cilat mund të sjellin pasoja të drejtpërdrejta që ndikojnë në mënyrën se si kjo vepër duhet realizuar", tha Meta.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të parë Ligjin për delegacionin e Kosovës në dialogun me Serbinë

LDK-ja dhe LV-ja, kundër Ligjit për dialogun

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) sërish kanë refuzuar ofertën e pushtetit për t'u bërë pjesë e dialogut me Serbinë. Këto dy subjekte opozitare, edhe pas një debati të gjatë parlamentar, kanë votuar kundër Ligjit për delegacionin e Kosovës në dialogun me Serbinë, të cilin Kuvendi e ka votuar me 61 vota. Sipas tyre, ky ligj nuk e kufizon presidentin e vendit dhe idetë e tij në këtë proces, ndërsa zyrtarët e koalicionit qeverisës dhe të PSD-së kanë treguar se ligji rregullon atë se çfarë mund të negociohet dhe çfarë nuk mund të negociohet në dialogun me Serbinë

EPOKA E RE Muhamet KOCI

Prishtinë, 3 shkurti - Kuvendi i Kosovës në orët e vona të së shtunës, me 61 vota për, ka votuar Ligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Më shumë se katër orë deputetët nga pushteti e opozita kanë zhvilluar një debat me kritika dhe akuza të ndërsjella dhe nuk kanë arritur të gjejnë një kompromis në mënyrë që edhe dy subjektet më të mëdhaopozitare të përfshihen në këtë proces.

Përfaqësuesit e koalicionit qeveritar dhe të partisë opozitare, PSD-së, kanë deklaruar se ligji rregullon atë se çfarë mund të negociohet dhe çfarë nuk mund të negociohet në dialogun me Serbinë kurse, sipas LDK-së dhe LV-së, ky dokument nuk ka asnjë vlerë. Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, i cili ka prezantuar para deputetëve këtë ligj, ka thënë se ligji në fjalë garanton të gjithë parametrat e duhur që çështja e përfaqësimit të Kosovës në dialog të rregullohet në mënyrë të mirëfilltë. Ai sërish i ka ftuar LDK-në dhe LV-në që të bëhen pjesë e këtij procesi.

"Dua ta shpreh vullnetin tonë që ne jemi të gatshëm qysh do që ju mendoni se ky ligj duhet të duket. Ajo që është me rëndësi është ta kemi një pjesëmarrje prej opozitës. Nuk është luftë partiake, por ne mund ta formësojmë projektligjin qysh të keni dëshirë. Edhe qëndrimi i subjektit tim politik është i qartë, ne duam ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës në këtë territor, në këtë kufi dhe jemi të gatshëm të bashkëpunojmë", ka thënë Hoxhaj.

Sipas tij, qeveria është e gatshme që platformën për këtë proces ta shkruajë në tërësi bashkë me këto dy subjekte opozitare.

Mirëpo LDK-ja dhe LV-ja nuk e kanë marrë parasysh ftesën e zëvendëskryeministrit Hoxhaj dhe e kanë kundërshtuar miratimin e këtij ligji. Sipas tyre, ky dokument nuk e ndal shkëmbimin e territoreve në mes të dy vendeve. Deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, ka thënë se ligji i jep legjitimitet dhe mbështetje të plotë politike presidentit Hashim Thaçi dhe legalizon planet e tij në proces. "Para nesh kemi një ligj që i jep legjitimitet presidentit dhe legalizon planet e tij për copëtim të vendit që deri tani nuk gjenin aleatë, por mbetnin nën plane ruso-serbe. Hap rrugë që negociatat për territor të vazhdojnë duke mos lënë asnjë vijë të kuqe për asnjë temë. Ky ligj lejon negocim edhe të shkëmbimit, asociacionit të komunave serbe etj. Ky ligj ka një kusht, që kur Thaçi të shkojë në Bruksel, t'i marrë edhe disa me vete, por disa të tjerë që nuk do të lejojnë copëtim, por që e legjitimojnë atë", ka thënë Osmani.

Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, e ka vlerësuar të pavlefshëm delegacionin shtetëror dhe ligjin. "Përfundimisht, qysh është i papranueshëm ky delegacion dhe i pavlefshëm, unë besoj se edhe ky projektligj do të duhej të konsiderohej i tillë dhe të kundërshtohet. Me këtë rast unë besoj se pati të drejtë në ofertën e tij zëvendëskryeministri, i cili tha se duhet të përfundojë në shportë ky dhe t'ia fillojmë nga fillimi. E, fillimi është 33 marrëveshjet e deritanishme t'i shqyrtojmë, kërkesat tona ndaj Serbisë për të cilën mund të krijojmë konsensus, zgjedhjet e lira demokratike, platforma me parime dhe ekipi negociator me udhëheqje kredibile. Ky është rendi i duhur i gjërave. Përndryshe, qasja antishtetërore po pasohet me procedura antidemokratike që ne, jo vetëm sot, por gjithmonë duhet t'u themi jo", ka thënë Kurti.

Vetëvendosje do ta dërgojë në Kushtetuese Ligjin për dialogun

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka bërë me dije se kjo parti do ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. "Ata që i kanë marrë votat e LV-së nuk kanë nevojë t'i legjitimojnë veprimet e Thaçit. Nëse i legjitimojnë, hajde të shkojmë në zgjedhje. Nuk ka nevojë dikush të marrë vendime me vota të LV-së. Ky projektligj është skandaloz në kuptimin politik dhe në emër të LV-së them se do ta çojmë në Gjykatën Kushtetuese", ka thënë Haxhiu.

Ambasadori Cufaj pret në takim një delegacion të studentëve nga Kosova

Berlin, 3 shkurt (ER) - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani, Beqë Cufaj, ka pritur në takim një delegacion të studentëve të Kosovës, të cilët janë duke qëndruar për vizitë zyrtare në Berlin. Gjatë këtij takimi, ambasadori Cufaj u ka premtuar atyre mbështetje në procesin e kandidimit për anëtarësim në Unionin Studentor të Evropës. "Përfaqësuesit e Unionit të Studentëve të Kosovës po qëndrojnë për vizitë zyrtare në Berlin, ku janë duke zhvilluar takime pune me Unionin e Studentëve të Gjermanisë (FZS). Udhëheqësit e dy organizatave, Unionit të Studentëve të Kosovës dhe ata të Gjermanisë (fzs), këtë fundjavë në hapësirat e ambasadës i ka pritur edhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Gjermani, Beqë Cufaj, i shoqëruar nga ministri këshilltar, Blerim Canaj. Unioni i Studentëve të Kosovës prihej nga kryetarja Krenare Çerkini dhe sekretari Valon A. Alija", është bërë me dije në njoftimin e Ambasadës së Kosovës në Gjermani.

Me këtë rast, ambasadori Cufaj ka shprehur përkrahjen e tij të plotë për iniciativën e përfaqësuesve të Unionit të Studentëve për marrëveshje bashkëpunimi me kolegët e tyre të Gjermanisë si dhe u ka premtuar atyre mbështetje në procesin e kandidimit për anëtarësim në Unionin Studentor të Evropës.

Flet për "Epokën e re", Zenun Pajaziti

Brenda këtyre ditëve do të

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka bërë me dije se partnerët e koalicionit qeverisës, në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, do ta gjejnë zgjidhjen e duhur për çështjen e taksës ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se taksa nuk do të paraqesë problem për funksionimin e koalicionit PAN dhe, sipas tij, nuk do të ketë luhatje në këtë drejtim. Pajaziti ka thënë se cilido që të jetë fati i taksës, ajo e ka arritur efektin e vet dhe nuk do të ketë luhatje të partneritetit me ShBA-në. Sa i perkat kërkesës për zgjedhje të reja, Pajaziti ka thënë se partitë opozitare nuk duhet të bëjnë fushata populiste, por pozitë e opozitë duhet të fokusohen në momentumin për zgjidhjen përfundimtare me Serbinë

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 SHKURT - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Zenun Pajaziti, ka thënë të dielën se miratimi i Ligjit të Buxhetit, Ligjit për Paga dhe Ligjit për Dialogun ka treguar se Kosova ka stabilitet shtetëror dhe, pavarësisht prej sfidave, mund të ecë sigurt përpara. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ai ka theksuar se me gjithë debatet, qëndrimet e ndryshme dhe vërejtjet, koalicioni qeverisës është funksional. "Është e rëndësishme se brenda koalicionit qeverisës ka një pajtim të plotë për procesin e dialogut. Me aprovimin e Ligjit për Dialog është vulosur një qëndrim i përbashkët i koalicionit që të vazhdohet ky proces dhe përmes këtij dokumenti do të përcaktohen edhe përgjegjësitë e atyre që do ta përfaqësojnë vendin në dialog, si dhe opozita do ta ketë derën e hapur. Çështjet e tjera që mund të paraqiten si pengesë ose si çështje të kushtëzuara për dialogun u mbeten liderëve të koalicionit që t'i zgjidhin në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe me ShBA-në", ka deklaruar Pajaziti, duke shtuar se partnerët e koalicionit qeverisës gjatë këtyre ditëve do ta gjejnë zgjidhjen e duhur për çështjen e taksës. Ai ka thënë se taksa nuk do të paraqesë problem për funksionimin e koalicionit PAN dhe, sipas Pajazitit, nuk do të ketë luhatje në këtë drejtim. "Koalicioni qeverisës do ta gjejë mënyrën dhe rrugën e duhur në partneritet me ShBA-në dhe BE-në për të ecur më tutje dhe nuk do të ketë luhatje. Mendoj se taksa nuk do të jetë pengesë në këtë drejtim. Madje jam i sigurt se brenda këtyre ditëve do të gjendet një zgjidhje", është shprehur ai. Kurse sa i perkat kërkesës për zgjedhje të reja, Pajaziti ka thënë se partitë opozitare nuk duhet të bëjnë fushata populiste, por pozitë e opozitë duhet të fokusohen në momentumin për zgjidhjen përfundimtare me Serbinë.

"Epoka e re": *Z. Pajaziti, është më stabil koalicioni PAN pas miratimit të Ligjit të buxhetit, Ligjit për paga dhe Ligjit për dialogun?*

Pajaziti: Fakti që të shtunën janë miratuar disa prej ligjeve më të rëndësishme, siç janë Ligji për buxhetin, Ligji për paga dhe Ligji për 'Trepçën', tregon se Kosova ka stabilitet shtetëror dhe kjo është më e rëndësishmja. Pra, miratimi i buxhetit në kohën kur kishte presion nga ana e opozitës, që ndërlidhej me stabilitetin e qeverisë dhe me zhvillimet aktuale rreth dialogut, ka dëshmuar se Kosova ka stabilitet dhe, pavarësisht prej sfidave, mund të ecë sigurt përpara.

"Epoka e re": *Por miratimi i këtyre ligjeve është përcjell me debate të ashpra si dhe ka pasur qëndrime të kundërta edhe brenda koalicionit.*

Pajaziti: Këto ligje nuk janë vetëm produkt i koalicionit qeverisës sepse aty kanë qenë të përfshira edhe partitë opozitare, pra ka qenë një përfshirje aktive e gjithë spektrit politik, sidomos te Ligji për paga. Pavarësisht se ka pasur dallime edhe në mes të koalicionit për çështje të ndryshme, është hera e parë që në Kosovë është arritur një konsensus me miratimin e këtij ligji. Kemi arritur ta përmbyllim një fazë të rëndësishme, por debati për këtë çështje nuk ka përfunduar. Mbetet që në të ardhmen të rregullohet edhe më mirë. Sidoqoftë, me gjithë këto debate, qëndrime të ndryshme dhe vërejtje, koalicioni qeverisës është funksional.

"Epoka e re": *Mirëpo aprovimi i këtij ligji ka ngjallur pakënaqësi te shumë sektorë të cilët konsiderojnë se nuk janë trajtuar si duhet. Mund të ketë përshkallëzim të pakënaqësisë sindikale?*

Pajaziti: Nuk përjashtohet mundësia që të ketë edhe ndonjë pakënaqësi, por Ligji për Paga i ka prekur të gjitha kategoritë në sektorin publik dhe duhet të përmendet fakti se është hera e parë që ka një rritje kaq të madhe të pagave. Ka një rritje e cila nuk u shkon në mënyrë lineare të gjithëve, por me këtë ligj janë saktësuar dhe korrigjuar të gjithë sektorët. Mund të ketë edhe

gjendet zgjidhja për taksën

lëshime, edhe pakënaqësi, por është shumë më lehtë që këto të përmirësohen ndërkohë.

"Epoka e re": *Z. Pajaziti, ky ligj ka arritur ta ndërpresë grevën në arsim, por LDK-ja dhe partnerja e koalicionit qeverisës, Nisma Socialdemokrate, e kanë akuzuar PDK-në dhe liderin e saj se ka orkestruar këtë grevë. Është e vërtetë një gjë e tillë?*
Pajaziti: Nuk ia vlen të komentohen këto spekulime dhe deklarata të zyrtarëve të këtyre partive. Kryetari i PDK-së, njëherësh lider i koalicionit, Kadri Veseli, ka pasur dhe ka rolin kyç për zgjidhjen e sfidave që paraqiten para nesh. Veseli ka arritur t'i ulë të gjithë faktorët në një tryezë dhe të ndihmojë për zgjidhjen e këtij problemi. Veseli mbetet lideri më i dëshmuar me angazhimin për zgjidhjen e sfidave dhe problemeve në shoqërinë tonë.

"Epoka e re": *Pavarësisht prej tentativave dhe takimeve të fundit, koalicioni qeverisës ende nuk ka arritur të ketë pajtueshmëri për heqjen e taksës ndaj Serbisë. Cila do të jetë formula për tejkalimin e kësaj çështje?*
Pajaziti: Është e rëndësishme se brenda koalicionit qeverisës ka një pajtim të plotë për procesin e dialogut. Me aprovimin e Ligjit për Dialog është vulosur një qëndrim i përbashkët i koalicionit që të vazhdohet ky proces dhe përmes këtij dokumenti do të përcaktohen edhe përgjegjësitë e atyre që do ta përfaqësojnë vendin në dialog si dhe opozita do ta ketë derën e hapur. Çështjet e tjera pastaj që mund të paraqiten si pengesë ose si çështje të kushtëzuara për dialogun u mbeten liderëve të koalicionit që t'i zgjidhin në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe me ShBA-në. Edhe këtu Veseli po angazhohet që ta ushtrojë përgjegjësinë e vet që i takon duke kërkuar nga liderët brenda koalicionit, por edhe nga opozita, që të kenë një pajtim sa më të madh me aleatët tanë kryesorë, ShBA-në dhe me BE-në.

"Epoka e re": *Po thoni se ka pajtim të plotë për ta vazhduar dialogun, por si mund të vazhdojë ky proces pa u hequr taksa?*
Pajaziti: Këto kërkesa apo kushtëzime duhet të trajtohen në ditët dhe javët e ardhshme brenda koalicionit dhe me partnerët ndërkombëtarë. Është me rëndësi që ka pajtim të plotë se duhet të shkohet në dialog dhe për çështjet e tjera pastaj mbetet të koordinohemi. Edhe çështja e taksës është një prej çështjeve kyçe e cila na obligon të gjithëve që ta ruajmë partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në ditët në vijim nuk besoj se do ta thellojmë këtë ndarje, por do ta tejkalojmë.

"Epoka e re": *Ka rrezik që taksa të bëhet shkaktare e rrëzimit të qeverisë?*
Pajaziti: Nuk e di se si do të jetë në saktësi puna e taksës, por kjo masë që është mirëpritur nga qytetarët e Kosovës ka ndikuar dukshëm në vetëdijesimin e qytetarëve dhe përfaqësuesve politikë për një vendosmëri më të madhe që jo vetëm të shkohet në dialog, por edhe të këmbëngulet që të ketë zgjidhje të duhur në raport me Serbinë. Nuk e di se si do të jetë fati e taksës, por një gjë e di, se ajo bëri efektin e vet si dhe që nuk do të ketë luhatje me ShBA-në. Pra, në plan të parë do të jetë ky partneritet.

"Epoka e re": *Janë gjasat më të mëdha që të gjendet zgjidhja për taksën apo të prishet koalicioni?*
Pajaziti: Koalicioni qeverisës do ta gjejë mënyrën dhe rrugën e duhur në partneritet me ShBA-në dhe BE-në për të ecur më tutje dhe nuk do të ketë luhatje. Mendoj se taksa nuk do të jetë pengesë në këtë drejtim, madje jam i sigurt se brenda këtyre ditëve do të gjendet një zgjidhje.
"Epoka e re": Opozita po insiston që taksa të mbetet e qeveria të largohet.
Pajaziti: Opozita po bën fushatë populiste për zgjedhjet e ardhshme me një kauzë e cila, më shumë sesa interes i partive politike, është interes i qytetarëve të vendit. Nuk do të duhej që me kauza të tilla të shërbehen qëllimet ditore politike. Edhe nga pozita mund të ketë qëndrime populiste, por opozita është aktualisht në agjendën partiake paraelektorale.

"Epoka e re": *Që do të thotë se mund të ketë zgjedhje të reja?*
Pajaziti: Duhet të jesh shumë komod dhe i papërgjegjshëm që të mendosh për kauza personale e partiake në kohën kur para nesh janë interesat shtetërore e kombëtare. Nëse na është thënë nga aleatët tanë se kemi një mundësi historike që të përmbyllet ky proces me Serbinë atëherë do të ishte papërgjegjësi e plotë sikur këtë gatishmëri ta devijojmë në agjenda partiake e zgjedhore. Madje kjo do të sillte një situatë kur nuk do të mund ta parashikojmë se kur do të vijë një momentum tjetër i përshtatshëm. Pozita e opozita duhet të fokusohen në agjendën që është e mbështetur nga partnerët tanë.

"Epoka e re": *Jeni optimist se do të mund të shfrytëzohet ky momentum për t'u finalizuar dialogu me Serbinë?*
Pajaziti: Historia jonë më e re dhe ngjarjet që kanë ndodhur që nga pas lufta kanë treguar se sa herë kemi qenë të përgjegjshëm dhe në koordinim me partnerët tanë nuk kemi dështuar. Nëse e ndjekim rrugën e njëjtë nuk do të dështojmë. Por, edhe nëse Serbia nuk do të jetë e gatshme për një zgjidhje përfundimtare, partneriteti ynë i çmuar me partnerët ndërkombëtarë do të na shërbejë për fazat e ardhshme në interes të Kosovës dhe zhvillimeve në rajon.

Sot fillon mësimi në të gjitha shkollat

Prishtinë, 3 shkurt (ER) - Nxënësit dhe mësimdhënësit, pas një greve trejavëshe, sot (e hënë) do t'i kthehen procesit mësimor. Marrëveshja për ndërprerjen e grevës në arsim është arritur të premten që lamë pas në takimin e përbashkët të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, kryeministrit Ramush Haradinaj dhe kryetarit të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), Rrahman Jasharaj. Me këtë rast kreu i SBAShK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se marrëveshja parasheh rritjen e pagave përafërsisht në nivelin që e kanë kërkuar mësimdhënësit, deri në 30 për qind. "Është tepër, tepër afër 30 përqindëshit. Nuk është 30 për qind por, kur ka dialog, kur ka negocime, duhet bërë edhe kompromise. Fitues jemi të gjithë. Është një marrëveshje e mirë sepse ka lëvizje të koeficientëve dhe angazhimi ynë që të mos jemi mes rangimit një e dy, tani me këto lëvizjet e reja, sistemi para universitar, çerdhet dhe të tjerat kalojnë nga koeficienti dy në tre dhe kjo është një arritje e mirë", ka thënë Jasharaj.
Edhe Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e fundit të mbajtur ka diskutuar për çështjen e organizimit të afatit të provimeve të janarit në njësitë akademike të UP-së. "Në këtë takim senatorët u pajtuan që nga e hëna të fillojë procesi i organizimit të provimeve si në afatet kohore në vijim: SEMS-i për paraqitje të provimeve do të jetë i hapur më datat 4 dhe 5 shkurt 2019; Datat e mbajtjes së provimeve: 6 shkurt 2019 deri më 28 shkurt 2019 (përjashtim nga këto data bëjnë ditët e festave zyrtare). Si rrjedhojë e kësaj, obligohen dekanët e njësive akademike që t'i riorganizojnë datat e provimeve për javët e humbura, sipas specifikave të njësive përkatëse. Po ashtu, informoheni se semestri veror për vitin akademik 2018-2019 në UP fillon më 25 shkurt 2019. Senati i Universitetit të Prishtinës u uron studentëve sukses në këtë afat të provimeve!", është bërë me dije në njoftimin e UP-së.
Po të shtunën në Kuvendin e Republikës së Kosovës është miratuar Projektligji për paga i cili do të mundësojë rritje të pagave për më shumë se 70 mijë punonjës të sektorit publik.

Rikonfigurimi i qeverisë, opsion më i mundshëm se zgjedhjet

Prishtinë, 3 gusht - Këmbëngulja e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, që të mos e pezullojë vendimin për taksën prej 100 përqindësh për produktet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, pavarësisht prej kërkesës për një pezullim të tillë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian, ka krijuar situatë mjaft të tensionuar brenda partnerëve të koalicionit qeverisës në vend, por edhe të skenës politike në përgjithësi, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në vend.

ShBA-ja dhe BE-ja kanë kërkuar pezullimin e taksës në mënyrë që t'i jepet mundësi vazhdimit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit. Përderisa kryeministri Ramush Haradinaj vazhdon të këmbëngulë për taksën ndaj mallrave serbe, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i cili është lider i partisë më të madhe brenda koalicionit qeverisës, Partisë Demokratike të Kosovës, është pajtuar për një pezullimin për 120 ditë të kësaj takse.

Njohësit e zhvillimeve politike vlerësojnë se mospajtimet ndërmjet partnerëve të koalicionit qeverisës janë duke rrezikuar ekzistencën e këtij koalicioni. Por, megjithatë, ata përjashtojnë mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme eventuale.

Artan Muhaxhiri, analist i çështjeve politike, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson se situata e krijuar në koalicionin qeverisës nuk mund të zgjasë. "Kriza e madhe politike, në të cilën gjendet Kosova, nuk mund të vazhdojë për një kohë të gjatë. Pra, nevojitet një zgjidhje e shpejtë, e cila mund të bëhet vetëm në dy mënyra. Pra, që kryeministri Haradinaj të heqë dorë nga taksa prej 100 përqindësh, ta pezullojë atë ose që të kemi një rikonfigurim të plotë të qeverisë, një ndryshim të kryeministrit dhe një përfshirje të Lidhjes Demokratike të Kosovës në qeveri. Pra, vetëm këto dy mundësi janë aktualisht realiste", ka thënë Muhaxhiri.

Mendim të ngjashëm me të ka edhe analisti tjetër Agon Maliqi. Ai thotë për "Radion Evropa e Lirë" se tashmë ekziston presion i madh ndërkombëtar që dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të përfundojë brenda këtij viti. Në këtë pikë, zgjedhjet e parakohshme do ta komplikonin situatën dhe mund të sjellin paqartësi edhe më tej. "Nëse Haradinaj nuk tërhiqet nga taksa, mendoj se gjasat më të mëdha janë që të ketë një rikonfigurim të qeverisë, brenda konstelacionit të tanishëm të Kuvendit të Kosovës. Kështu i lexoj edhe deklaratat e fundit të LDK-së. Përderisa LDK-ja më herët më shumë bënte thirrje për zgjedhje, sikur është tërhequr pak prej asaj kërkese. Duket sikur po çon drejt krijimit, mbase të një qeverie të re, e cila ende nuk dihet se a do të jetë LDK - PDK apo do të përfshijë edhe të tjerë. Por, ajo duhet ta ketë një lloj peshe më të madhe për ta shtyrë përpara procesin shumë delikat që e kemi sivjet", ka theksuar Maliqi.

Se rikonfigurimi i qeverisë mund të jetë një opsion i mundshëm për të dalë nga situata e krijuar brenda koalicionit qeverisës, tashmë ekzistojnë sinjale që janë dërguar nga partitë politike, të pushtetit dhe opozitës, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike.

Analisti Muhaxhiri thekson se kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, e ka përmendur më parë opsionin e përfshirjes së partisë së tij në një qeveri gjithëpërfshirëse, e cila do të ishte e rikonfiguruar dhe e ndryshuar krejtësisht. "Është e pritshme që edhe me një presion të madh amerikan dhe nga BE-ja, LDK-ja të përfshihet në këtë moment në një qeveri gjithëpërfshirëse, sepse opsioni i zgjedhjeve të reja nuk është aq real, pasi merr shumë kohë dhe nuk ka asnjë garanci që pas zgjedhjeve mund të kemi një qeveri stabile, që do të formohej shpejt", u shpreh Muhaxhiri.

Ndërkaq analisti Maliqi vlerëson se edhe nga partneri më i madh në koalicionin qeverisës, Partia Demokratike e Kosovës, janë dhënë sinjale se mund të shkohet drejt rikonfigurimit të qeverisë. "Prononcimi i (Kadri) Veselit, se Kosova në asnjë rrethanë nuk duhet të shkojë kundër interesave të ShBA-së, është mesazh i qartë se PDK-ja nuk është e interesuar ta vazhdojë bashkëpunimin në rast se Haradinaj nuk e ndryshon qëndrimin. I paqartë mbetet pozicioni i partnerëve të tjerë, në këtë rast i Nismës (Socialdemokrate), por edhe i Partisë Socialdemokrate (PSD), e cila nuk është në qeveri, por është përfshirë në procesin e dialogut nga pozicioni i opozitës. Edhe këto të dyja janë të rëndësishme në rast të një rikonfigurimi të madh, sepse vetëm PDK-ja dhe LDK-ja mbeten të pamjaftueshme për llojin e sfidave të cilat i kemi përpara", ka vlerësuar Maliqi.

Qeveria e Kosovës më 21 nëntor të vitit të kaluar kishte vendosur taksën prej 100 përqindësh për produktet nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina si kundërpërgjigje ndaj politikave të këtyre dy vendeve ndaj pavarësisë së Kosovës. Më pas, autoritetet e Serbisë patën theksuar se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën nuk do të vazhdojë derisa vendimi për taksën të mos tërhiqet.

PDK-ja ka përmbyllur zgjedhjet në 420 nëndegë

Prishtinë, 3 shkurt (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) është duke vazhduar procesin e brendshëm zgjedhor, ndërsa në këtë javë janë mbajtur dhjetëra kuvende të nëndegëve në të gjitha komunat e Kosovës, me pjesëmarrje të madhe të delegatëve të të gjitha profileve që i janë bashkuar PDK-së dhe vizionit të kryetarit Kadri Veseli për platformën "Dekada e Re".

Vetëm në nëndegën e PDK-së në lagjen Korillë të Prizrenit kanë marrë pjesë 386 delegatë, ku kryetari i nëndegës është zgjedhur Erven Fusha si dhe organet e tjera drejtuese.

Qindra delegatë kanë marrë pjesë edhe në proceset zgjedhore në nëndegët e Skenderajt, Deçanit, Rahovecit, Prizrenit, Klinës, Vitisë, Kamenicës, Vushtrrisë, Suharekës dhe degë të tjera, të cilat kanë hyrë në dinamikë të shtuar për ta përmbyllur procesin e brendshëm zgjedhor i cili do të rezultojë me zgjedhjen e strukturave të reja të PDK-së në 1200 nëndegë në gjithë vendin.

Deri tani PDK-ja ka përmbyllur me sukses zgjedhjet në 420 nëndegë.

Ndërkaq, gjatë mbajtjes së dhjetëra kuvendeve të nëndegëve, në fshatin Studenicë të Istogut, mbrëmë procesi zgjedhor është përcjell me parregullsi, andaj është ndërprerë dhe pritet të vijojë në ditët e ardhme, në pajtim me Rregulloren për zgjedhje të brendshme.

Gjatë procesit të zgjedhjeve të brendshme, PDK-së i janë bashkuar shumë anëtarë të rinj, intelektualë, studentë, mjekë, inxhinierë, bujq, arsimtarë dhe profile të tjera.

Koha e ribërjes së Shqipërisë

Mëdyshja e shtruar në këtë kohë vendimesh të mëdha ka dy opsione që përjashtojnë njëra-tjetrën: në duam një Kosovë të plotë në funksion, të cunguar në praktikë dhe jofunksionale në realitet, apo një Kosovë që do të dilte si rezultat i opsioneve të hapura jashtë çdo tabuje dhe që do të sillte një paqe të qëndrueshme afatgjate?

Nga: Ismet HAJRULLAHU

1. Sigurisht se që të gjithë do të kishin pranuar një kombinim të dilemës, por kjo duket e pamundshme, sepse s'kanë thënë kot latinët e vjetër se nuk ka rregulla pa përjashtime. Opsioni i parë tashmë është i njohur. Kështu është duke frymuar që nga viti 1999. KFOR-i, i udhëhequr nga NATO-ja, nuk e integroi veriun dhe sovraniteti i Kosovës atje aspak nuk është i pranishëm. Ajo pjesë është e shkëputur. Nëse nuk kemi guximin që ta pranojmë këtë, atëherë duhet të ofrojmë mënyrë konkrete, rrugë të duhur dhe mjete të përshtatshëm se si ta kthejmë atë pjesë. Atje vepron e gjithë struktura shtetërore e Serbisë. Kështu ka qenë që tetë vjet, por askush nuk e di se si mund të ndryshojë kjo gjendje. Madje, askush nuk ka dashur që të merret seriozisht me këtë çështje. Problemi mbetet i tillë kur ai heshtet, kur nuk vihet në tryezë të bisedimeve. Debati në politikë është faza e parë e zgjidhjes së problemit. Ne nuk kemi shkelur as në fazën e parë të kësaj zgjidhjeje. Askush nuk ka dalë me një ide apo plan të menduar mirë se si do të inkuadrohej veriu në sovranitetin e Kosovës. Të gjithë e kanë lënë për nesër dhe ka rrezik që kjo e nesërme të mos mbërrijë kurrë. Klasa politike nuk dëshiron ta kujtojë këtë makth. Më lehtë e ka të bëjë politikë pa halle, duke u ikur atyre pafundësisht deri në labirintin e moszgjidhjes. Madje-madje, duke mos çarë kokën fare për këtë problem aq të madh, duke mos u lodhur se resurse mjaft të rëndësishme janë "matanë", politikanë të caktuar marrin guximin që ta paragjykojnë çdo ide, bile edhe ato që vijnë nga qarqe serioze vendimmarrëse, me plane jo të favorshme për zgjidhjen apo për kompensimin e asaj që tani s'e kemi më në dorë.

Kur jemi ende te "Kosova aktuale", e plagosur në gjymtyrë dhe në brendi, do të duhej të ritheksonim se Pakoja Ahtisaari vërtet ofron një formë të pavarësisë, por mbase lidershipi ynë u nxitua që pa e menduar mirë (qoftë edhe për strategji diplomatike), të ngrejë shqetësimin e drejtë se kush do ta bashkojë veriun, ku është karakteri unitar i shtetit të ardhshëm, kur brenda Kosovës komunat serbe kanë pozitën e San Marinos dhe të shteteve të ngjashme me atributet e plota të një shteti brenda shtetit? Si do të funksionojë ky shtet në aspektin e administratës qendrore, vendimeve nga disa qendra e pushteteve të përziera edhe nga jashtë; si shpjegohen "zebrat" e krijuara me të ashtuquajturin decentralizim? Për të mos u dukur se bëjmë një kthim prapa në vlerësimin e gjërave, ajo që është shikim përpara ka të bëjë me çështjen bazë se kush vërtet në të ardhmen do ta integrojë veriun brenda Kosovës?

2. Këtu nuk kemi të bëjmë me supozime të parakohshme, sepse nuk kemi kohë për të pritur e për të parë, por tani është kohë e përqendrimit të të gjithë trurit kombëtar se cili do të ishte vendimi më largpamës në këtë kohë me përgjegjësi mbase më të madhe historike që nga viti 1912? Pyetja konkrete që mund të bëhet këtu, lidhet me faktin se kush do ta inkuadrojë veriun në kohën kur vetë NATO-ja e la atë të ndarë? Parimet e Grupit të Kontaktit mes të cilave edhe parimi se "nuk ka ndarje", tashmë janë thyer. Janë shkelur nga vetë ata që i ngritën këto qëndrime. Tani gjithçka është e mundur, nuk ka më tabu. Këtu është përgjegjësia e madhe historike, e cila kërkon, madje, një largpamësi jo profetike, por të një analize të hollësishme se si shqiptarët ta kapin hapin e madh historik. Ne, madje, edhe mund të supozojmë gjithnjë duke menduar të shikojmë përtej asaj që shohim: çfarë do të ndodhë me veriun kur pas 10 dhjetorit do të fillonte njohja e pavarësisë së Kosovës? Kush dhe si do ta vinte atje autoritetin e shtetit të Kosovës? A do të ishte ajo pjesë një burim i përhershëm incidentesh e konfliktesh? Do ta çlironte atë trupa kosovare, apo ushtria serbe do ta okuponte atë përfundimisht? Nga kjo e fundit del edhe çështje tjetër: Cilat do të ishin ngjashmëritë dhe dallimet mes Kosovës dhe Qipros, apo Libanit etj? Me veriun shqiptarët do të humbasin shumë, përfshirë jo vetëm resurset nëntokësore, por edhe ujin e Gazivodës. Por, politika, si art i të mundshmes, duhet të masë dy gjera për të njëjtin rast: a ka mundësi ruajtja e veriut dhe si? Çështja tjetër që në vetvete ngërthen dy çështje është: nëse nuk ka mundësi kthimi i veriut, a duhet që shqiptarët të vazhdojnë të këmbëngulin më kot për gjenë e humbur, apo për këtë të kërkojnë kompensim, që do të thotë këmbim territoresh?

Dhe si çështje e tretë dhe e veçantë që shtrohet për t'u analizuar nga pala shqiptare (Prishtina e Tirana) është se a duam një zgjidhje afatgjate dhe që garanton qetësi në të ardhmen, apo duam një zgjidhje që do të shoqërohet me incidente përgjatë linjë kufindarëse ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, një paqe afatgjate apo një zgjidhje të përkohshme? Padyshim se më e parapëlqyera do të ishte zgjidhja afatgjate dhe prandaj tashmë del e qartë se pa tabu dhe me të gjitha opsionet e hapura, ka ardhur koha që shqiptarët dhe serbët të merren vesh për një kufi etnik. Politika shqiptare (Prishtinë, Tiranë) duhet që ta elaborojë në hollësi çdo skutë gjeografike dhe të jetë e gatshme edhe për këtë opsion. Mendja e politikanëve shqiptarë duhet të dalë nga korniza e dogmatizuar në dhjetëvjetëshat e fundit se duhet me çdo kusht një Kosovë e ndarë nga gjysma e trungut tjetër shqiptar. Politika shqiptare duhet të ofrojë në tavolinë zgjidhjet e elaboruara dhe të argumentuara mirë. Pyetja që duhet të marrë përgjigje është se a duhet vazhduar këmbëngulja për ta ruajtur diçka që na ka dalë nga dora, apo të kompensojmë atë humbje me diçka tjetër që më herët na është marrë? Kjo nuk do të thotë heqja dorë nga resurset aq të rëndësishme, por gjithashtu shtron dilemën e këmbëngulësisë shterpe dhe qëndrimi pragmatist për të fituar të mundshmen.

Rishikimi i kufijve në baza etnike do të ulte gjakrat në rajonin e trazuar dhe shqiptarët dhe serbët më në fund do të arrinin paqen.

Prandaj, Prishtina e Tirana nuk duhet t'u tremben varianteve të zgjidhjes, por t'i hartojnë ato sa më mirë që të jetë e mundur, sepse tani gjithçka është e mundur. Një Shqipëri, e cila do të mbërrinte në Lindje deri pranë kufirit bullgar, do t'i kthente shqiptarët në udhëkryqet e rëndësishme të Evropës. Do të ishte një ribashkim i natyrshëm dhe një ngushëllim i vonuar. Ndoshta po bie kambana e ribërjes së Shqipërisë.

(Ky shkrim është botuar më 24 gusht 2007, si editorial në gazetën "Lajm", ku autori në atë kohë ishte kryeredaktor i kësaj gazete)

Tahiri thotë se Haradinaj nëpërmjet taksës ia ka ndalur rrugën Thaçit në Bruksel

Prishtinë, 3 shkurt - Ish-ministrja e Dialogut, Edita Tahiri, ka deklaruar se kryeministri Ramush Haradinaj, në pamundësi që ta ndalë rrugën e presidentit Hashim Thaçi në Bruksel, ka vendosur taksën e cila, sipas saj, ka bllokuar dialogun me Serbinë. Duke shprehur qëndrimin e saj kundër korrigjimit të kufijve, ajo ka thënë se Hashim Thaçi duhet të ndalet përmes institucioneve. Sipas saj, një marrëveshje që prek kufijtë, është marrëveshje që çon në luftë. Ajo në një intervistë për "Kosovapress" ka thënë se udhëheqësit institucionalë, përfshirë këtu presidentin e vendit, duhet të hartojnë një deklaratë, ku secili hedh firmën aty, dhe e njëjta siguron që nuk do të ketë ndryshim të kufijve.

Bujar Tërstena (RFE/RL)

'Trepça' bëhet me statut

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në orët e para të së dielës propozimstatutin e Shoqërisë Aksionare "Trepça". Në favor të këtij statuti kanë votuar 80 deputetë, dy ishin kundër, ndërsa tre kanë abstenuar. Statuti i aprovuar i "Trepçës" mundëson zbatimin e Ligjit për "Trepçën" si dhe adreson çështjet kryesore për konstituimin dhe funksionalizimin e kësaj ndërmarrje

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 SHKURT - Me 80 vota për, dy kundër dhe tri abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për statutin e "Trepçës" si shoqëri aksionare. Statuti i aprovuar i "Trepçës" mundëson zbatimin e Ligjit për "Trepçën" si dhe adreson çështjet kryesore për konstituimin dhe funksionalizimin e ndërmarrjes, siç janë: Regjistrimi formal administrativ i "Trepçës" si Shoqëri Aksionare, Kompletimi i Bordit Mbikëqyrës siç parashihet me Ligjin mbi "Trepçën", Zgjedhja dhe emërimi i Bordit Menaxhues, si dhe fillimi i investimeve siç parashihet me Ligjin mbi "Trepçën".

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë se miratimi i statutit të ndërmarrjes i hap rrugë perspektivës zhvillimore të "Trepçës" si dhe bën të mundur fillimin e investimeve vendore dhe të huaja, duke rritur vlerën e aseteve dhe duke përmirësuar teknologjinë, të cilat do të mundësojnë që "Trepça" të rikthehet në një nga gjigantet kryesor të zhvillimit ekonomik të Kosovës. "Njëkohësisht duke përmirësuar mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik. Dua të shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë aktorët të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për finalizimin e statutit të 'Trepçës': Punëtorët e 'Trepçës', bordin mbikëqyrës, sindikatën, grupet punuese, kolegët nga kabineti qeveritar, komisionin parlamentar për zhvillim ekonomik si dhe të gjithë deputetët e Kosovës. Përfundimisht mbyllëm një kapitull disavjeçarë dhe tani fokusi kryesor do të jetë që ky aset të rikthehet në motorin kryesor të zhvillimit ekonomik, duke rritur eksportet, përmirësuar bilancin tregtar dhe duke gjeneruar vende pune për qytetarët tanë", ka thënë Lluka.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se me votimin e statutit të "Trepçës" është zgjuar gjiganti kosovar. "Ky është hapi kryesor për t'i dhënë këtij aseti fuqinë për investime dhe gjenerim stabil të të hyrave dhe punësim. Votimi i statutit me 2/3 e votave të Kuvendit dëshmoi unitet të spektrit politik. Ky statut i jep 'Trepçës' legjitimitetin e nevojshëm për të operuar me të gjitha kapacitetet e saj dhe duke e rikthyer atë në funksion të plotë të ekonomisë së vendit, të shtetit të Kosovës dhe të minatorëve", ka thënë Haradinaj.

Edhe kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të "Trepçës", Ardian Syla, ka thënë se me miratimin e statutit të "Trepçës" u hapë rruga për zbatimin e plotë të Ligjit për "Trepçën", si dhe për krijimin e infrastrukturës ligjore për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të ndërmarrjes më të rëndësishme në sektorin minerar në Republikën e Kosovës. "Përveç miratimit të statutit, 'Trepça' përfitoi edhe nga miratimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Me miratimin e buxhetit 'Trepça' përfiton në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes linjës buxhetore të paraparë për paga si dhe linjës buxhetore të paraparë për investime kapitale. Me këtë buxhet stabilizohet sadopak gjendja financiare në ndërmarrje", ka thënë Syla.

Ndërkaq kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të "Trepçës", Shyqyri Sadiku, ka thënë se me aprovimin e statutit për "Trepçën" hapen rrugë për zhvillim ekonomik, përmirësim të kushteve sociale për punëtorët dhe për punësimin e të rinjve. "Aprovimi i statutit për 'Trepçën' është fitore e minatorëve, të cilët me këmbëngulësinë e tyre arritën që të gjitha kërkesat e tyre të inkorporohen në statut", ka thënë Sadiku.

Lekaj: 298 milionë euro janë ndarë për projekte në komunat e Kosovës

PRISHTINË, 3 SHKURT- Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka bërë me dije se 298 milionë euro është buxheti i kësaj ministrie me të cilin kanë paraparë projekte për secilën komunë të Kosovës. "Autostrada e Dukagjinit, ajo e Gjilanit, segmenti Kijevë - Zahaq dhe një mori projektesh madhore infrastrukturore për Kosovën janë pjesë e buxhetit 2019 që mori miratimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Me buxhetin më të madh dhe të planifikuar si duhet për nevojat e qytetarëve, që Kosova ka pasur ndonjëherë, Qeveria Haradinaj po e shtyn përpara zhvillimin ekonomik të vendit", ka thënë ministri Lekaj.

Kalon buxheti, 2 miliardë e 370 milionë euro për vitin 2019

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar në lexim të dytë Projektligjin për buxhetin e vitit 2019, që është paraparë të jetë 2 miliardë e 370 milionë euro. Po ashtu, deputetët votuan edhe propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr 06/L-20 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 SHKURT- Kuvendi i Kosovës ka votuar Ligjin për buxhetin e vitit 2019. Për Ligjin për buxhetin kanë votuar 65 deputetë. Buxheti për vitin 2019 është paraparë të jetë në vlerë prej 2.3 miliardë eurosh. Dy partitë më të mëdha opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, nuk kanë votuar për buxhetin për vitin 2019. Po ashtu, deputetët votuan edhe propozimvendimin e Qeverisë së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-20 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përshëndetur miratimin në lexim të dytë të Projektligjit për buxhetin 2019 të Republikës së Kosovës, me 2 miliardë e 370 milionë euro, duke theksuar se ky është buxheti më i madh dhe më zhvillimor i deritanishëm i Kosovës që do t'i paraprijë rritjes ekonomike prej 4.7 përqindësh.

Kryeministri Haradinaj ka vlerësuar se me buxhetin më të madh në historinë e saj, Kosova hyn në etapë të re zhvillimore. "Arsimi me rreth 300 milionë euro dhe shëndetësia me 234 milionë euro janë sektorët që përfitojnë më së shumti. Institucionet e sundimit të ligjit dhe mbrojtjes marrin mbështetje të shtuar financiare prej 6 përqindësh krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar. Më shumë siguri dhe më shumë mbrojtje, edhe për qytetarët, por edhe për investimet", ka theksuar kryeministri Haradinaj.

Investimet kapitale, sipas kryeministrit Haradinaj, rriten për 11 për qind, apo 75 milionë në raport me vitin 2018, duke mundësuar realizimin e shumë projekteve ekzistuese dhe të reja, si nxitje e madhe për zhvillim ekonomik dhe për sektorin privat dhe se janë akomoduar mjetet për rritjen e pensioneve bazike 20 për qind, për ato kontributdhënëse 15 për qind, si dhe pensionet mujore prej 230 eurosh për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Kryeministri Haradinaj, ndër të tjera, e ka uruar Kosovën duke e quajtur këtë si vitin e kthesës ekonomike.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri veseli, ka thënë se miratimi i buxhetit për vitin 2019 është një vendim i rëndësishëm për vendin. "Buxheti për vitin 2019 prej 2.3 miliardë eurosh u hap rrugë zhvillimore sektorëve më jetikë të dekadës së re, ekonomisë e ndërmarrësisë, arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, sportit, kulturës dhe inovacionit. Faleminderit të gjithë deputetëve!", ka thënë Veseli.

Gjatë kësaj seance, me 63 vota për dhe një abstenim, deputetët votuan po ashtu Ligjin për pagat në sektorin publik. Kryetari i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Nait Hasani, gjatë paraqitjes së rekomandimeve të këtij komisioni, lidhur me Ligjin për pagat, tha se ky ligj ofron nivelizim të pagave në sektorin publik. "Mendoj se me këtë projektligj dhe listën që është e bashkëngjitur, ne ia kemi arritur qëllimit që të paktën t'i nevilizojmë, t'i japim meritat secilit ku e ka dhe t'i japim atyre që duhet dhe të vlerësojmë edhe institucionet e shtetit për mbrojtje dhe siguri. Të gjitha institucionet e kanë vendin e merituar për punën që e bëjnë, prandaj për punën e njëjtë, paga e njëjtë. Ky ligj i siguron të gjithë atë në formën në të cilën janë miratuar amendamentet nga komisioni. Çdo ndryshim i amendamenteve ose çdo votim kundër e çrregullon këtë sistem dhe do ta kemi një gjendje më të keqe sesa që e kemi pasur deri tash", ka thënë Hasani.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se me miratimin e Ligjit për pagat do të përfitojnë 70 për qind e punonjësve të sektorit publik që, sipas tij, "po e përjetojnë rritjen më të madhe të pagave të tyre".

Para miratimit në Kuvend të këtij ligji, kreu i Kuvendit, Kadri Veseli, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka thënë se Projektligji për pagat ofron vetëm rritje për punonjësit në sektorin publik. "Me këtë ligj po i japim fund arbitraritetit dhe anarkisë që kanë mbizotëruar në këtë fushë për pothuajse 20 vjet. Pagat u janë rritur të gjithë mësimdhënësve, personelit shëndetësor, policëve, ushtarëve, shërbyesve civilë dhe të gjitha kategorive të tjera në sektorin publik. Kemi bërë një ligj të standardeve më të mira, duke respektuar meritat e secilës kategori që paguhet nga buxheti i shtetit. Askujt nuk do t'i ulet paga ekzistuese. Ligji parasheh vetëm rritje. Tani fokusi do të jetë në sektorin privat. Për rritjen e prodhimit vendor dhe nxitjen e ndërmarrësisë të hapë vende të reja pune dhe me paga më të larta", ka thënë Veseli.

Ish-ministri Hasani: Paga minimale në Kosovë vazhdon të jetë diskriminuese

PRISHTINË, 3 SHKURT - Me 63 vota për dhe një abstenim Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për pagat në sektorin publik. Lidhur me këtë ka reaguar ish-ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajaram Hasani. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se paga minimale në Kosovë vazhdon të jetë diskriminuese. "Ndonëse ka kaluar më shumë se një vit, kur si pjesë e Këshillit Ekonomik Social kemi vendosur ta rrisim pagën minimale në 250 euro, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në vendin tonë kemi njerëz që marrin pagën minimale prej 130sh dhe 170 eurosh, që jetojnë në mjerim, nuk mund të sigurojnë as gjërat elementare të jetesës", ka shkruar Hasani. Ai ka thënë se sa më parë duhet të votohet edhe rritja e pagës minimale pasi, sipas ish-ministrit Hasani, në këtë mënyrë do t'i jepej mbështetje sektorit privat, si sektori më i shkelur dhe nëpërkëmbur. "Ta bëjmë vendin tonë një vend që respekton punën dhe djersën e të gjitha kategorive. Qytetarët e Kosovës e meritojnë të jetojnë me dinjitet. Respektojeni dinjitetin e punëtorit të ndershëm të Kosovës", ka shkruar Hasani.

Republika e Kosovës
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

Shëndetësia, prioritet i qeverisjes së Elezajt në Klinë

KLINË, 3 SHKURT (ER) - Në Komunën e Klinës është mbajtur tryeza e organizuar nga organizata joqeveritare "Koha", me temë "Shëndetësia në Komunën e Klinës, angazhimi, sfidat dhe e ardhmja".

Gjatë kësaj tryeze, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Klinë, Hekuran Sejdiu, ka prezantuar raportin e punës për vitin 2018 si dhe planin e punës për vitin 2019, me ç'rast ka theksuar se shëndetësia është prioritet i qeverisjes komunale të drejtuar nga Zenun Elezaj dhe se janë të vendosur në këtë rrugë. Në këtë kontekst, Sejdiu ka kërkuar mbështetjen e të gjithëve për përmirësimin e shërbimit shëndetësor në Klinë. "Falënderim të veçantë për OJQ-në 'Koha' dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë tryezë", ka thënë Sejdiu.

Haziri uron nxënësit dhe mësimdhënësit për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë

GJILAN, 3 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka uruar nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Gjatë takimit me drejtorët e shkollave fillore, të mesme dhe institucioneve parashkollore, është konfirmuar se gjithçka është gati për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të mësimit. "Uroj nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit për fillimin e mësimit në gjysmëvjetorin e dytë, duke shpresuar shumë se sukseset e fëmijëve dhe të shkollave në përgjithësi në komunën tonë të jenë gjithnjë më të larta. Kërkohet një angazhim i përbashkët nga mësimdhënësit dhe prindërit që të kemi nxënës të suksesshëm", ka thënë Haziri.

Në shkollat e Gjilanit, përpos në gjuhën shqipe, mësimi zhvillohet edhe në gjuhën serbe, turke e rome.

Gashi: Me miratimin e buxhetit zbatohet edhe Ligji për Obiliqin

OBILIQ, 3 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, ka falënderuar deputetët e Kuvendit të Kosovës për miratimin e buxhetit të shtetit për vitin 2019. Ai ka thënë se falë miratimit të buxhetit do të bëhet edhe implementimi i Ligjit për Obiliqin. "Përmes këtij buxheti bëhet edhe implementimi i Ligjit të Obiliqit, duke rritur kështu buxhetin e komunës tonë për plus 4 972 124 euro, e që në total buxheti do të jetë 12 168 718 euro", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, Gashi ka falënderuar për mbështetje kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrin e Financave, Bedri Hamza. "Falënderim të veçantë për kryeparlamentarin Kadri Veseli, kryeministrin Ramush Haradinaj dhe ministrin e Financave, Bedri Hamza, si dhe të gjitha komisionet parlamentare që punuan për realizimin e Ligjit për Obiliqin. Ju ftoj ta zhvillojmë bashkë komunën tonë, t'i realizojmë projektet me sukses në të mirën e të gjithë neve, t'i gëzojmë bashkërisht. Suksese!", ka shkruar Gashi.

Komuna e Skenderajt furnizon me dru për ngrohje 40 familje skamnore

SKENDERAJ, 3 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se kanë filluar shpërndarjen e druve për ngrohje për dyzetë (40) familje skamnore të kësaj komune. Me këtë rast, Jashari ka falënderuar donatorët të cilët e kanë përkrahur këtë iniciativë. "Kemi filluar shpërndarjen e drunjve për dyzet familje që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, që këta muaj të mbetur të dimrit t'i kalojnë pa problemin e mungesës së drunjve për ngrohje. Falënderoj Shpëtim Arifin, Avdullah Lushtakun dhe Bedri Zejnullahun, si donatorë të kësaj ndihme shumë të mirëseardhur, sidomos për 40 familje, ku secila prej tyre ka përfituar nga tri metra kub dru", ka theksuar Jashari.

Ngrica në Qeverinë e Kosovës

Bedri ISLAMI

Në Kosovë, prej disa ditëve, në partnerët e koalicionit qeverisës, të gjitha forcat politike me fillesë në liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë nisur shenjat e para të ngrirjes së ndërlidhjeve të tyre, të cilat, me gjithë dëshirën për të bashkëqeverisur, mund ta sjellin prishjen e qeverisë dhe kalimin në zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme, të cilat, sipas Kushtetutës së Kosovës, duhet të mbahen në një hapësirë 45 ditore.

Shkaku i ngrirjes që duket e mundshme është qëndrimi ndaj taksave të vendosura nga qeveria e Kosovës ndaj Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, një taksë 100 për qind ndaj mallrave që vijnë nga këto dy vende ballkanike.

PDK-ja e drejtuar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, në ditët e fundit, ndoshta edhe nga presioni ndërkombëtar, i gjithanshëm dhe i përditshëm, propozoi që për 120 ditë të hiqet dorë nga taksat e vendosura, për të lejuar vazhdimin e bisedimeve të ndërprera me shtetin serb.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dikur drejtuesi i kësaj force politike, shkon edhe më tej. Ai ka kërkuar të hiqen pa kushtëzim taksat e vendosura dhe të hapet rrugë e menjëhershme për tryezën e munguar të bisedimeve. Thaçi, nisur edhe nga letra e Presidentit Amerikan, Trump, përmes së cilës, mes të tjerave, kërkohet edhe heqja e shpejtë, pa ekuivok e taksës së vendosur, do të ishte i pari që kërkoi këtë lëshim ndaj shtetit serb, por që, po aq shpejt dhe aq e vendosur, qeveria e Kosovës, nuk e ndërroi qëndrimin e saj.

Kryeministri Haradinaj, jo vetëm si drejtues i qeverisë, por edhe si njeriu që i prin forcës së katërt politike në Kosovë, AAK-së, me gjithë presionin ndaj tij, nuk heq dorë nga e drejta e Kosovës për të vetëvendosur dhe për të lidhur qëndrimin e qeverisë që drejton me krijimin e raporteve të reja politike në Ballkan, sidomos sa i takon Kosovës.

Ai i mbetet qëndrimit të mbështetur nga shumica e shqiptarëve në Kosovë se, për të dhe qeverinë që drejton, e drejta e vendosjes së taksave dhe tarifave mbetet vetëm e tyre dhe se ato mund të hiqen dhe të krijohet një gjendje e re kur shteti serb të njohë Kosovën dhe të mos e trajtojë atë si një koloni financiare, dhe ku, përmes saj , të mos bëhen më financime të paligjshme.

Edhe Nisma mban të njëjtin qëndrim. Partia e drejtuar nga Limaj dhe ku dallohet si njeriu i mendimit politik kryetari i Grupit Parlamentar, Bilall Sherifi, shkon edhe më tej. Nisma ka përcaktuar rrugën e deri tashme si të vetmen të drejtë dhe se, si ka theksuar, sa herë që kemi bërë lëshime ndaj shtetit serb, aq herë kemi dështuar.

Çështja e Kosovës është ndër më të përvëluarat sot për sot. Qëndrimi abuziv i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, duke u fshehur pas asaj që do të vendoset në Uashington e në Bruksel, si deklaroi në intervistën e tij të fundit në vizitën private në Gjermani, jo vetëm është fshehje e kokës në rërën e mjegullës, por edhe i bie ndesh Kushtetutës së Shtetit Shqiptar në preambulën e saj. Shqipëria duhet të ketë qëndrimin e saj pa ekuivok, edhe pse në ndonjë gjë mund të bjerë ndesh me dëshirat e mëdha dhe të rrahura nga politika e përkohshme, sidomos në dy gjëra të mëdha dhe të rëndësishme: në përcaktimin ndaj çështjes së kufirit, si gjë e përcaktuar dhe e pa vënë në Pazar, dhe, në mbrojtjen e qëndrimeve të qeverisë së Kosovës, që, për herë të parë ndoshta, dëshmon se kërkon të bëjë shtet.

Çfarë do të ndodhë në Kosovë?

Dy partitë e opozitës, LDK-ja dhe Lëvizja Vetëvendosje, ndonëse të ndryshme në formim, në përbërje, në sfida dhe në afishim e tyre politik e ideologjik, ndërsa janë të një mendje për rënien e qeverisë, kanë për dallim në çështjen e taksës me shtetin serb. LDK, përmes heshtjes, kërkon heqjen e këtij detyrimi; Lëvizja VV, përmes fjalës, synon mbajtjen e saj.

Rënia e qeverisë nuk i shkon askujt tjetër për shtat, veçse dy anëve të njëjta të politikës: politikës serbe në Beograd, që edhe kështu ndodhet në hallin e saj, dhe, si edhe më herët, lobit serb që ndodhet në vetë politikën shqiptare.

Një qeveri e rënë dhe një shtet pa qeveri mund të kapërdihet më lehtë nga bashkëbiseduesit e regjur serbë dhe nga lehtësuesit e regjimit të saj në qeveritë evropiane.

Së bashku me qeverinë, do të binte edhe Grupi negociator i miratuar nga parlamenti dhe qeveria, edhe drafti i përgatitur. Kosova do të gjendej pa parlament, bashkësia ndërkombëtare do të kishte, si edhe më parë, përballë tryezës vetëm një bashkëbisedues, që, edhe një ditë më parë, në Letrën e tij drejtuar Presidentit Amerikan, dëshmon se është i gatshëm dhe i vullnetshëm të bëjë gjithë kompromiset e nevojshme…

Rrëzimi i qeverisë dhe futja në zgjedhje të parakohshme, si duket, nuk e ka trembur edhe aq shefin e qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai i ka bërë llogaritë se, edhe nëse në pak ditë qeveria bie, taksat do të mbeten së paku deri në fundin e muajit qershor.

Haradinaj është në pikën e tij më të lartë të mbështetjes dhe, duhet pranuar se, këto javë, ndjenja nacionale dhe vetë nacionalizmi si prirje ndaj mbështetjes qeveritare, është rritur në Kosovë. Prej saj Haradinaj mendon se do të ketë përfitimet e tij politike dhe, duan apo nuk duan, ai do i ketë këto.

Nga shumë studiues të pavarur në Kosovë, mbështetja ndaj Haradinajt, ka ardhur nga pikëllimi i një hapësire boshe të krijuar nga politika e deri tashme në rrafshin e jashtëm, ku, si nuk është pritur, lëshimet e bëra ndaj shtetit serb e kanë dobësuar politikën e Kosovës, kanë lënë pas vetes shumë enigma dhe, të cilat, si nuk është pritur, kanë krijuar një fushë të hapur për shtetin serb.

Edhe Nisma nuk është e trishtuar nëse vendi do të shkojë drejt zgjedhjeve të eja politike, por, nga ana tjetër, nuk e kanë në planin e tyre lëshimin dhe tërheqjen nga vendimi qeveritar lidhur me taksat ndaj mallrave dhe produkteve serbe.

U bënë gati 20 vite që mes Prishtinës dhe Beogradit, herë haptas dhe herë tinëzisht, luhet një lojë denigruese dhe mohuese e gjithë çka ndodhur në Kosovë.

Përmes bisedimeve dhe arritjes në tryezë të asaj që ligjërisht e ka humbur, shteti serb dhe politika e saj e konstruktuar në mendimin e saj akademik, e ka perceptuar Kosovën si një koloni beogradase dhe qëndrimi i qeverisë në Prishtinë e ka gjetur atë të papërgatitur.

Mirë që ka ndodhur kështu.

Megjithëse ajo që është vendosur në Prishtinë nuk ka gjetur entuziazëm në politikën jashtë saj, sidomos në ShBA, ka qenë një masë e domosdoshme, e gjetur dhe shpresëdhënëse.

Për më tepër, ajo nuk e ka rënduar ekonominë e Kosovës, por ka mbyllur rrugët e babëzisë së oligarkisë së re financiare e politike në Kosovë, rrënjët e të cilëve shpesh herë gjenden në Beograd.

Kërkohet që shtatorja e Zahir Pajazitit të vendoset në Tiranë

PODUJEVË, 3 SHKURT (ER) - Historiani dhe asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje në Podujevë, Florent Hasani, ka kërkuar që edhe shtatorja e heroit të kombit, Zahir Pajazit, të vendoset në Tiranë, krahas figurave të tjera kombëtare, Skënderbeut, Hasan Prishtinës dhe Adem Jasharit. Hasani ka thënë për "Epokën e re" se kërkesën për vendosjen e shtatores do ta bëjë bashkërisht me autorin e emisioneve "Gjurmë Shqiptare" në "Top Channel", Marin Memen. "Kërkesa do t'i dorëzohet kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj dhe Ministrisë së Kulturës. Vlerësojmë se kontributi i Zahir Pajazitit për çlirim e bashkim kombëtar ishte një kontribut i jashtëzakonshëm dhe i pandalshëm që nga rinia e tij e hershme e deri në momentet e fundit të jetës së tij. Zahiri është një ikonë që, krahas një vendi meritor që duhet ta ketë në historinë kombëtare, meriton një vend edhe në kryeqytetin shqiptar, Tiranë", ka thënë Hasani.

Diplomatët e ShBA-së dhe Koresë së Jugut takohen para samitit Trump-Kim

UASHINGTON, 3 SHKURT - Zyrtarë të lartë të Shteteve të Bashkuara dhe të Koresë Jugore janë takuar, ku kanë biseduar për samitin e dytë ndërmjet presidentit amerikan, Donald Trump dhe udhëheqësit të Koresë së Veriut, Kim Jong Un.
Të enjten presidenti Trump tha se do të njoftojë shumë shpejt lidhur me datën dhe vendin ku do të mbahet samiti me Kimin, raporton AP. I dërguari i posaçëm i Trumpit në Korenë e Veriut, Stephen Biegun, ka arritur në Korenë e Jugut të dielën. Mediet kanë raportuar se ai mund të takohet me zyrtarët verikoreanë javën e ardhshme, me qëllim që të përcaktohen detajet e samitit.
Ministria e Jashtme në Seul tha se Biegun dhe homologu i tij nga Koreja e Jugut, Lee Do-hoon kanë pasur konsultime lidhur me bisedimet ndërmjet SHBA-së dhe Koresë së Veriut.
Mediet në Korenë e Jugut thonë se i dërguari i ShBA-së, Stephen Biegun dhe homologu i tij verikorean, Kim Hyok Chol janë takuar në fshatin kufitar mes dy Koreve, Panmunxhom ose në kryeqytetin e Koresë së Veriut, Phenjan, më herët gjatë kësaj jave.

Rusia tërhiqet nga traktati për armët bërthamore

Presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se Rusia po pezullon pjesëmarrjen në traktatin INF, të nënshkruar gjatë Luftës së Ftohtë, për armatimin bërthamor me rreze të mesme

Moskë, 3 shkurt - Shtetet e Bashkuara dhe Rusia po reagojnë me lëvizje të njëpasnjëshme për sa i përket traktatit të armëve bërthamore. Politikanët dhe analistët e shikojnë këtë si një rigjallërim të garës për armatim. Presidenti rus Vladimir Putin deklaroi se Rusia po pezullon pjesëmarrjen e saj në traktatin INF, të nënshkruar gjatë Luftës së Ftohtë, për armatimin bërthamor me rreze të mesme.
Lëvizja ruse pason hapin e ngjashëm të ndërmarrë nga Shtetet e Bashkuara të premten. "Do të veprojmë në këtë mënyrë. Përgjigja jonë do të jetë simetrike. Partnerët amerikanë deklaruan se do të ndalin pjesëmarrjen e tyre në traktatin INF, kështu që edhe ne do të ndalemi. Ata deklaruan se zhvillojnë armë të reja dhe ne do të bëjmë të njëjtën gjë", tha presidenti rus Putin.
Putini tha se Rusia nuk do t'i pozicionojë këto armë, nëse SHBA-ja nuk ndërmerr një veprim të ngjashëm. "Rusia nuk do të pozicionojë armë të reja me rreze të shkurtër dhe të mesme, as në Evropë dhe as në rajone të tjera të botës, përderisa Amerika nuk do të pozicionojë armë të ngjashme në këto zona", tha Putini.
Presidenti rus tha se ka udhëzuar ministrin e Jashtëm dhe atë të Mbrojtjes të mos iniciojnë bisedime me Uashingtonin për këtë çështje.
Gjatë një deklarate të shtunën, presidenti amerikan Donald Trump njoftoi se Shtetet e Bashkuara po pezullojnë zbatimin e traktatin që kanë qenë në fuqi prej dekadash, duke akuzuar Kremlinin se e ka shkelur atë qëllimisht.
"Për një periudhë tepër të gjatë, Rusia ka shkelur pa u ndëshkuar Traktatin për Armët Bërthamore me Rreze të Mesme, duke zhvilluar fshehurazi dhe duke pozicionuar një sistem të ndaluar raketash që kërcënon drejtpërsëdrejti aleatët dhe forcat tona ushtarake jashtë vendit", tha presidenti Trump. "Ne nuk do t'iu përmbahemi kushteve të traktatit, ndërkohë që Rusia gënjen për veprimet e saj", tha ai.
Por, duke folur më vonë me gazetarët, Trumpi la të hapur mundësinë e një lloj marrëveshjeje. "Shpresoj të mblidhemi të gjithë në një sallë të madhe dhe të bukur dhe të arrijmë një marrëveshje të re që do të ishte shumë më e mirë. Do të pëlqente shumë të shikoja diçka të tillë, por duhet të bien të gjithë dakord", tha ai.
Ministria e Jashtme e Kinës deklaroi se Pekini është kundër tërheqjes së Uashingtonit nga traktati dhe u bëri thirrje ShBA-së dhe Rusisë t'i menaxhojnë qëndrimet e tyre të ndryshme përmes një dialogu konstruktiv.
Traktati INF, i nënshkruar nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Sovjetik në vitin 1987, ishte marrëveshja e parë në botë që ndaloi një klasë të tërë armësh, më saktësisht raketat e lëshuara nga platforma tokësore që mund të arrijnë një rreze veprimi nga 500 deri në 5500 kilometrash.

Shkeljet e traktatit INF

Shtetet e Bashkuara kanë folur gjithnjë e më haptazi për ato që i quan shkelje flagrante të Rusisë. Zyrtarët amerikanë të mbrojtjes dhe të zbulimit thonë se shkeljet janë shfaqur që në vitin 2014, kur Rusia filloi dislokimin e raketave 9M729, pas vitesh testimi në shmangie të kufizimeve të përcaktuara nga traktati.
Zyrtarët thonë se tashmë Rusia po pajis batalione të shumta ushtarake me këtë lloj rakete. "Ne duhet të reagojmë", u tha të premten gazetarëve Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo. "Nuk mund t'i përmbahemi më traktatit, ndërsa Rusia po e shkel atë paturpësisht", tha ai.
ShBA-ja i dorëzon të dielën Kremlinit dhe vendeve të tjera që kanë qenë pjesë e Bashkimit Sovjetik, njoftimin zyrtar për synimin për t'u tërhequr nga traktati INF, duke shënuar kështu edhe fillimin e periudhës transitore 6-mujore të parashikuar në marrëveshje.
Zyrtarë thonë se nëse Moska refuzon t'i shkatërrojë raketat, traktati do të marrë fund dhe SHBA-ja do të jetë në gjendje t'i zhvillojë sistemet e saj me rreze të mesme, të pozicionuara në platforma tokësore apo mjete detare.
Në një deklaratë të bërë menjëherë pas njoftimit amerikan, NATO-ja u shpreh se vendet e saj anëtare mbështesin plotësisht këtë hap. "Rusia është në shkelje reale të Traktatit INF dhe duhet t'i shfrytëzojë 6 muajt në vazhdim për t'u rikthyer plotësisht brenda parametrave të traktatit ose të mbajë të gjithë përgjegjësinë për prishjen e traktatit", shkroi në Twitter Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.
Zyrtarët e OKB-së shprehën shqetësimin e tyre. "Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së shpreson që palët t'i shfrytëzojnë gjashtë muajt e ardhshëm për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet përmes dialogut. Traktati INF është një pjesë shumë e rëndësishme e arkitekturës për kontrollin e armatimit ndërkombëtar", u tha gazetarëve zëdhënësi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Stephane Dujarric.
Ndërkohë pati reagime të përziera nga ligjvënësit amerikanë, ndërkohë që kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, tha se: "Administrata Trump po rrezikon të krijojë një garë armatimi dhe të cenojë sigurinë dhe stabilitetin ndërkombëtar. Moszbatimi i pacipë i Rusisë të këtij traktati është thellësisht shqetësues. Por, të heqësh një nga shtyllat kryesore të kuadrit tonë të sigurisë krijon rreziqe të papranueshme", deklaroi Pelosi.
Disa analistë mendojnë se nëse SHBA-ja fillon zhvillimin e raketave të reja, kjo do t'i mundësojë përballjen me rreziqet në rritje nga vende si Kina dhe Irani, të cilat nuk janë pjesë e Traktatit INF. ShBA-ja beson se këto vende kanë në arsenalin e tyre mbi 1 mijë raketa me rreze të mesme veprimi.

Papa Françesku viziton Emiratet e Bashkuara Arabe

VATIKAN, 3 SHKURT - Papa Françesku, udhëheqësi i kishës katolike, po bën vizitën e parë ndonjëherë nga një papë në Gadishullin Arabik, ku ka lindur feja islamike. Ati i Shenjtë mbërrin në Emiratet e Bashkuara arabe të dielën për një konferencë ndërfetare. Ai kthehet në Romë nesër (e martë).
Para se të largohej nga Vatikani, Papa tha se ka ndjekur krizën humanitare në Jemen me shqetësim të madh dhe u bëri thirrje të gjitha palëve që t'i respektojnë marrëveshjet ndërkombëtare dhe të garantojnë mbërritjen e ushqimeve te jemenasit që po vuajnë.
Në takimin "Vëllazëria njerëzore" sot (e hënë) do të marrin pjesë udhëheqës të besimeve myslimane, të krishtera, hebraike, hindu, budiste dhe të tjera.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E jashtëzakonshme

Zbulohet varri me 50 mumie në Egjipt

Arkeologët egjiptianë kanë gjetur 50 mumie që datojnë në Epokën e Ptolemeut (305-30BC), ka njoftuar Ministria e Antikiteteve. Mumiet, nga të cilat 12 pre tyre ishin fëmijë, u gjetën në katër dhoma varri, 9 metra të thella në zonën e Tuna El-Gebel në Minya, në jug të kryeqytetit Kajro. Disa ishin të mbështjellë me pëlhurë liri, të tjerë në arkivole guri ose në sarkofagë prej druri.

FOTO E DITES

Njerëzit kalojnë afër një peme të mbuluar me akull në Ontario të Kanadasë. /AFP/

E rrallë

Kina importon gomarë për ta rritur ekonominë

Në mënyrë që të sigurojë rritje në sektorin e eksportit, Kina do të importojë gomarë, duke i hapur rrugë fitimit të milionave nga tregtia. Një zyrtar në Departamentin e Bagëtive në Khyber Pakhtunkhwa (K-P) ka konfirmuar importin e kafshëve nga Pakistani. Globalisht, Pakistani ka numrin e tretë më të madh të gomarëve, ndërsa Kina qëndron në vendin e parë.

BARSOLETA E DITËS

Profesori e pyet nxënësin:
- Tregoma ndonjë personalitet me famë botërore.
- Ronaldo, Messi, Kaka e të tjerë.
- A nuk e njeh Betovenin, Mozzartin e të tjerët?
- Rezervistët nuk i njoh për besë, se luajnë rrallë!

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Jeta ka ende shumë gjëra për t'ju ofruar dhe sot do t'ju mbushet mendja për këtë gjë. Do të gjeni arsye të largoheni për pak ditë.

DEMI
Do të keni një udhëtim pune që në nisje do të mbartë shumë stres. Por, kur të përfundojë, ju do të jeni fitimtarë dhe mjaft të kënaqur.

BINJAKËT
Sot do të keni mjaft afrim me parterin, që ju kishte munguar kohët e fundit. Atmosfera romantike do të mbizotërojë përgjatë gjithë ditës.



LUANI
Jeni mjaft diplomat sot. Megjithëse keni ndjenja të thella karshi një personi, do të arrini të mbani nën kontroll çdo sjellje tuajën.

VIRGJËRESHA
Në familje do të keni mjaft gjëra për të thënë sa i përket një vendimi që është marrë pa praninë tuaj. Mundohuni të arrini në një zgjidhje.

PESHORJA
Komunikimi është arma juaj fituese në çdo çast. Do të arrini të gjeni mënyra alternative për t'i zgjidhur ngërçet e krijuara në punë.

AKREPI
Përqendrohuni te faktet sot pa u marrë me fjalë të kota që mund t'ju shpërqendrojnë nga objektivi juaj final.



SHIGJETARI
Sot ju mungon entuziazmi i zakonshëm për t'i bërë gjërat. Do të shikoni që nuk mund të shkoni shumë larg pa këtë detaj.

BRICJAPI
Me kolegët po kaloni kohë shumë të mira falë një bashkëpunimi që sapo keni nisur. Në shoqëri të tyre do të mësoni shumë gjëra.

UJORI
Sot keni nostalgji për të kaluarën dhe për tradicionalen. Kjo kohë ju sjell më pranë kujtimeve të fëmijërisë që këto ditë po ju shoqërojnë.

PESHQIT
Dita e sotme do të ketë suksese të njëpasnjëshme në të gjitha fushat. Edhe pse të tjerët ju paragjykojnë pa të drejtë, ju nuk do të mërziteni fare.



PESHQIT
Dita e sotme do të ketë suksese të njëpasnjëshme në të gjitha fushat. Edhe pse të tjerët ju paragjykojnë pa të drejtë, ju nuk do të mërziteni fare.

Reese Witherspoon darkon me familje në Los Anxhelos

Aktorja hollivudinane, Reese Witherspoon, pasditen e së shtunës u fotografua nga paparacët teksa ishte duke shëtitur fëmijët në rrugët e Los Anxhelosit. Pos fëmijëve, me të ishte edhe me bashkëshorti i saj, Southern Belle. Sipas "Daily Mail", ata darkuan në "Pacific Palisades".

Nicki Minaj thotë se i dashuri i saj e bën shumë të lumtur

Reperja e famshme botërore Nicki Minaj ka thënë se është shumë e dashuruar. Në një intervistë për "Queen Radio" ka thënë se e njeh të dashurin e saj, Kenneth Petty, nga mosha 14-vjeçare. "Unë e kam njohur Kennethin që kur isha 14 vjeç, këtu ka një nivel tjetër të pasionit dhe të miqësisë në mes të dyve. Ai gjithmonë di ç'të thotë për të më bërë të fuqishme. Unë jam shumë e lumtur me të", ka thënë Minaj.



Dua Lipa thyen ligjet e modës

Këngëtarja nga Kosova, Dua Lipa, kohët e fundit është duke korrur suksese të shumta në botën e muzikës. Pos këngëve ajo po komentohet edhe për dukjen. Dua Lipa ka postuar disa fotografi në rrjetin social "Instagram" ku thotë se është veshur si babagjysh.

Arrestohet reperi i njohur

Bow Wow u arrestua në orët e hershme të mëngjesit të së shtunës pasi dyshohet se u rrah me një grua. Reperi 31-vjeçar dhe Leslie Holden u arrestuan pasi policët arritën në vendin e ngjarjes në 4:15 në Atlanta. Leslie ka pohuar se ishte sulmuar nga Bow Wow dhe ai pretendoi se ajo e kishte sulmuar atë. Të dy kanë pësuar lëndime të lehta.

Austria e ndihmoi shkollimin, shkencën dhe kulturën shqiptare dhe pavarësisë shqiptare

Mr. Sci. Hazir MEHMETI,
Vjenë

Që nga kohët kur Austria ishte një perandori në Evropë dhe përfshinte shumë territore, arsimit dhe edukimit i dha një vend të veçantë. Dhe, jo vetëm në territorin që sot e zotëron, por në të gjitha hapësirat e perandorisë së saj. Pikërisht në Austri qe atëherë u bë mësimi fillor për të gjithë fëmijët pa marrë parasysh gjininë, i detyruar me ligj për të parën herë në kontinent. Kjo u përcoll me ngritjen e infrastrukturës shkollore: godina shkollore, universitete e biblioteka të pasura, teatro, shumica e të cilave tani vizitohen nga miliona njerëz nga gjithë bota. Nuk është i rastësishëm zhvillimi i gjenive me emrat si: Mozarti, Shtrausi, Karl Gega, Ajnstajni e shumë të tjerë. Investimet në arsim janë baza më e fuqishme e perspektivës së shoqërisë, respektivisht e një kombi.

Kjo frymë pozitive kishte rëndësi për progresin në kulturë e shkencë në kontinent edhe te kombet e tjera, pra edhe të shqiptarëve. Shqiptarët kudo që u gjenden jashtë territoreve etnike në fillim të shekullit të njëzet kishin përqendruar veprimtarinë e tyre në jetësimin e idealeve të rilindësve në bërjen e alfabetit dhe shtetit shqiptar. Sundimi i gjatë osman e kishte dëmtuar çdo gjë shqiptare, në radhë të parë gjuhën, trashëgiminë kulturore, fetare, zakonet. Edhe në trevat shqiptare filloi të ndihet rritja në kërkim të identitetit kombëtar për çka duhej liria dhe shteti i lirë. Idetë e tyre të shprehura natyrshëm, të trashëguara bashkë me lashtësinë e kombit shqiptar, u shkruan e rishkruan gjithandej shtypit të kohës krahas brumosjes së tyre në zemrat shqiptare.

Kështu ndodhi edhe në Vjenë, ku studiuan intelektualë, tani të njohur në historibërjen kombëtare. Në fletushka dhe gazeta kohe u botuan vargjet e Naim Frashërit, vepra dhe jeta e tij në fillimin e shekullit të Pavarësisë nga "Kolonia Shqiptare e Austrisë". Studentë e intelektualë, të mbledhur rreth "grupit iniciues", krahas botimeve, ndërtuan struktura organizative me programe të fuqishme me interes kombëtar. Ata themeluan shoqërinë "Liria", emër synonim i qëllimit, e cila në vitin 1904, do të ndërrojë emër në Shoqërinë "Dija". Emrat e dr. Gjergj Pekmezit, kryetar, Hilë Mosit, Kristo A. Dako, Kolë Kodheli, Dervish Hima, Ndue Paluca (Batusha), Kolë Rrota, Simon Kadarja, Gaspër Beltoja, Gaspër Mikeli, Kolë Margjini, Lec Çurçia dhe po aq të tjerë do të jenë emra të respektuar në letërsinë, kulturën dhe historinë kombëtare. Shoqëria e intelektualëve shqiptarë i kishte vënë vetes qëllime patriotike.

Kontributi në arsimimin dhe ngritjen kulturore u përcoll me hartimin dhe botimin e librave, duke filluar nga abetarja në vitin 1903 dhe e dërguar në atdhe, gramatika e gjuhës shqipe dedikuar gjermanofolësve dhe atij shqiptar, ndër të parat në Evropë nga intelektuali patriot dr. Gjergj Pekmezi. Për disa vjet me radhë në Vjenë u botua "Kalendari", një fletushkë me ngjarjet e vitit të sapokaluar, e cila botohej edhe te kombet e tjera. Në këtë periudhë për herë të parë nisi zanafilla e shkencave shqiptare, kryesisht nga studiuesit gjermanë të cilët kishin botuar e botonin vepra studimore lidhur me shqiptarët. Shumë nga këto studime janë aktuale dhe të pacenueshme edhe në kohën tonë. Duhet veçuar këtu veprat e shkencëtarëve të kohës mbi historinë e shqiptarëve, arkeologjinë shqiptare, etnografinë shqiptare, folklorit, të gjuhësisë, duke vënë kësisoj themelet e para të studimeve albanologjike me një vërtetësi të pakontestueshme. Shkencëtaret austriakë vunë themelet e studimeve në shkencat natyrore si në botanikë, zoologji, arkeologji, gjeografi, në shkencat medicine etj. Pra, veprimtaria studiuese e shkencëtarëve gjermanofolës është me rëndësi të gjithanshme dhe të një rëndësi historike për kombin shqiptar i cili vuante nën robërinë aziatike për pesë shekuj. Pa dyshim në studimin e historisë, gjuhës, kulturës e zakoneve të popullit shqiptar, studiuesit gjermanë zënë vendin e nderit si themelues të studimeve albanologjike si shkencë mbi shqiptarët. Që nga Arnold Fon Harffi me fjalorthin e tij historik, vazhdojnë emrat e njohur nga radhët e studiuesve gjermanofolës: Johannes Thunman me veprën e tij "Hulumtime mbi Historinë e popujve të Evropës Lindore", e vitit 1774; Jakob Philipp Fallmerayer me veprën e njohur "Elementi Shqiptar në Greqi", München 1857; Dr. Johannes Georg von Hahn "Studime Shqiptare" 1854 në tri vëllime; Gustav Meyer "Fjalor etimologjik të gjuhës shqipe"- Strasburg, 1891; Franz Baron Nopcsa, Jan Urban Jarnik, dr. Norbert Jokl, Maximilian Lambertz, Franc Xaver Ritter Miklosich, Theodor Ippen e shumë të tjerë.

Shtrirja e Perandorisë Austro-Hungareze në territoret shqiptare e filluar më 23 janar 1916, paraqet një fat të ri historik për çështjen e përgjithshme shqiptare. Barbaria e pushtuesve turq, serbomalazezë dhe greko-bullgar u zëvendësua me një pushtet civilizues dhe çlirimtar për popullin shqiptar, në veçanti për shqiptarët e Kosovës. Në Vjenë do të qëndrojnë herë pas herë disa personalitete të njohura kombëtare, si: Faik Konica, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Ahmet Zogu.

Delegacioni i trojeve shqiptare në Vjenë para "Hotel Bristolit" më 17 prill 1917 për ta falënderuar Perandorinë e Austro-Hungarisë për pavarësinë dhe mbështetjen e vazhdueshme historike ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë.

Kjo kishte rëndësi për themelimin dhe ndërtimin e administratës shtetërore dhe të shkollave shqipe. Gradualisht gjuha shqipe u bë gjuha e vendit, u krijuan rrethanat për zvogëlim të analfabetizmit kombëtar.

Në nëntorin e vitit 1916 Hasan Prishtina kërkoi bashkimin e të gjitha viseve shqiptare në një njësi shtetërore administrative nën administrimin e Vjenës. Në trevat shqiptare u lejua administrata në gjuhën shqipe, shkolla, flamuri, himni kombëtar. Vetë perandori austriak atij i kishte garantuar se nëse fiton blloku i tij "Shqipëria do të mbetej e bashkuar në kufijtë etnikë". Austro-Hungaria financoi shoqëri kulturore, gazeta, revista, si në Vilajetin e Shkodrës dhe më gjerë, deri në Vjenë. Kjo u realizua përmes inteligjencës shqiptare, të cilët kishin kryer studimet në Austro-Hungari dhe që përbënin pjesën më të ngritur të intelektualëve shqiptarë. Prirja e shqiptarëve për t'u arsimuar në shkollat e Austrisë është e hershme dhe kjo prirje nuk ishte vetëm te shqiptarët katolikë të Shqipërisë Veriore, por edhe te shqiptarët ortodoksë të Elbasanit, Korçës, Voskopojës, Gjirokastrës, Lunxhërisë, si dhe te shqiptarët e besimit islam kudo. Mbresa e jashtëzakonshme që ua kishte lënë tregtarëve shqiptarë të Shkodrës, Voskopojës, Beratit, Elbasanit, institucionet shtetërore austriake, se si duhet ndërtuar vendin, do të jetë shembull i përkryer i funksionimit të shtetit me gjithë disiplinën, përgjegjësinë, rregullin qytetar, shkollat, institucionet që do të ndërtoheshin në Shqipëri. Për inteligjencën shqiptare tani shteti austriak ishte ideal evropian.

Qëndrimi miqësor i Austrisë ndaj shqiptarëve është i hershëm. Kjo vjen jo vetëm për shkak të rivalitetit gjeostrategjik në raport me Austro-Hungari përballë Rusisë, por edhe nga lidhjet e vjetra që ishin vënë qysh nga kohët e hershme (1699 me Traktatin e Karllovcit neni. XIII). Kjo përkrahje është më e theksuar në pjesën veriore të Shqipërisë, veçan në krahinën e Mirditës, banorët e së cilës janë të besimit katolik. Qe para vitit 1855 në Shkodër kishte shkolla private të cilat financoheshin nga qytetarët shkodranë. Më 1859 Perandoria Austriake hapi shkollat e para fillore në Shkodër dhe Seminarin Pontefik me 20 nxënës (U. A., f. 60). Në periudhën 1855-1861 numri i nxënësve u rrit. Ata fillimisht mësonin në gjuhën italiane,

Norber Jokl (1877-1942

Hile Mosi ne Klagenfurt

pasi gjuha shqipe ishte e ndaluar nga pushteti. Në shkollat e para u regjistruan vetëm djem, kurse më vonë hapet shkolla për vajza e mësueset e para ishin Tushe Mici e Terezina Bërdica. Me ndihmën austriake kleri katolik ishte pro politikës arsimore austro-hungareze, kështu që në vitin 1877 me urdhrin jezuit hapet në Shkodër Kolegji Saverian. Ndihma austriake jepej drejtpërdrejt nga konsulli austriak i Shkodrës (U. B., f. 61). Po në vitin 1877 hapet Seminari Françeskan i cili u bë vatër e patriotizmit shqiptar. Hapja e shkollave vazhdoi në Vilajetin e Shkodrës si në: Shirokë (1873), Troshan (1882), Banjzë të Kastratit(1891), Blinisht dhe Selcë të Kelmendit (1893) dhe në Traboinë etj.

Në konkurrencë për ndikim në popullatën vendore me italianët të cilët hapnin shkolla laike, edhe Austria e shtoi hapjen e shkollave. Sipas evidencës nga diplomatët austriakë në Shqipërinë e pavarur numërojnë 26 shkolla të kategorive të ndryshme. Qeveria e Austro-Hungarisë politikën arsimore ndaj Shqipërisë e zbatoi edhe për dhënien e bursave për studime të të rinjve në qendrat e ndryshme të perandorisë duke përfshirë këtu Vjenën, Gracin e qendra të tjera. Student që u dërguan për studime në Austri mes viteve 1880-1890 dhe vitet 1900-1905 në drejtimet teologji dhe shkollat publike do të shënojmë: Pjetër Gjura, Lazër Mjeda, Vinçenc Prenushi, Anton Harapi, Mathe Prenushi, Luigj Bumçi, ndërsa mësuesit që shkëlqyen ishin: Hilë Mosi, Kol Kodheli, Ndue Paluca, Kolë Margjini e disa të tjerë.

Në mësimet albanologjike, pa dyshim, një nga figurat madhore është Norbert Jockli, albanolog hebre, pastaj Franz Nopca, ndër të parët themeltarë të albanologjisë si shkencë, të cilën e vazhduan pastaj nxënësit e Jocklit, siç ishin Eqrem Çabej, Aleks Buda, Lasgush Poradeci etj.

Një nga veprimtarët pararendës të kësaj plejade studiuesish, pa dyshim ishte dr. Gjergj Pekmezi, me iniciativën e tij në Institutin e Orientalistikës së Vjenës u hap katedra e gjuhës shqipe në vitin

Faik Konica, Dr.Gjergj Pekmez, Fan Noli

1903, një nga të parat në Evropë dhe në botë, ku do të studiohej gjuha shqipe. Dr. Pekmezi ishte edhe nga të parët ligjërues i gjuhës shqipe në UN-e Vjenës deri në vitin 1938.

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912, roli i intelektualëve që u shkolluan në Austri ishte domethënës. Librat mësimorë si, abetare, matematika, libra mbi dituritë natyrore kryesisht ishin të hartuara nga autorë të shkolluar në Austri. Mësimi në klasat e larta të shkollës fillore zhvillohej sipas konspekteve dhe metodave didaktike austriake. Qeveria e Ismail Qemail bej Vlorës ("Qeveria Provizore e Vlorës"), që në hapat e parë i kushtoi rëndësi të veçantë shkollimit. Ajo trashëgoi një gjendje katastrofe në arsim.

Nga marrëdhëniet e ndërtuara mes Shqipërisë dhe Austro-Hungarisë u dha mundësia e dërgimit të të rinjve shqiptarë për studime në universitet austriake Vjenë, Graz, Insbruk. Ky aktivitet u mbështet fuqishëm nga miqtë e shumtë austriakë dhe të personaliteteve të njohura shqiptare si Faik bej Konica, Hilë Mosi, Aleks Drenova, Visar Dodoni, Nikollë bej Ivanaj, Petro Nini Luarasi e të tjerë.

Luigj Gurakuqi kishte arritur mirëkuptimin me austriakët që të shtohet numri i bursistëve shqiptarë që do të studiojnë në Austri. Prej grupeve të para nga Elbasani dërgohet kontingjenti i studentëve në vitet 1917/18, i cili do të pasohet edhe disa vjet më vonë. Kontribut me vlerë dhanë Sali Butka dhe Hajdar Kolonja të cilët dërguan studentë kolonjarë të cilët pastaj u dalluan si mësues të devotshëm të Shqipërisë. Deri në Kongresin e Lushnjës sistemi arsimor në Shqipëri është mbështetur tërësisht në sistemin arsimor austro-hungarez.

Pjesë e kësaj kohe ishin disa nga figurat e njohura për kulturën, shkencën e historinë shqiptare të kohës: Hilë Mosi, Ndue Paluçe, Lec Çurçia, Kolë Kodheli, Gasper Beltoja, Gaspër Mikeli, Nikollë Rrota, Karl Gurakuqi, por edhe mësues e figura të tjera patriotike me rëndësi kombëtare. Nga diskutimet në Parlamentin Shqiptar del se në vitin 1924 në Austri studionin 69 studentë shqiptarë. Kjo flet për përparësitë që i kishte dhënë shkollimit të kuadrove nga qeveria në të gjitha profilet aq të nevojshme për Shqipërinë. Disa nga ministrat për arsim në qeveri do të jenë intelektualë të shquar të shkolluar në Austri, mes tyre ishin edhe Hilë Mosi e Kristo Dako. Qeveria shqiptare u ndau bursa studentëve shqiptarë pas vitit 1920 dhe caktonte përgjegjës rreth rrjedhës së studimeve nga bursistët. Këtë funksion e kreu dr. Gjergj Pekmezi deri më 1924, pastaj dr. Nush Bushati, Çatin Saraçi, Ndue Paluca, Kolë N. Rrota, dhe në vitet e Luftës së Dytë Botërore ishte Filip Llupi. Me këto bursa studiuan në Austri këto personalitete: Nush Bushati, Fuad Asllani, Remzi Baçe, Sokrat Dodbiba, Xhevat Korça, Jakov Deliana, Irakli Buda, Rrok Gera, Ndoc Saraçi, Gjevalin Gjadri, Jani Basho, Karl Gurakuqi, Hifzi Korça, Kristo Kristidhi etj. Arsimtarët e rrethit të Shkodrës, të shkolluar në Austri, me veprimtarinë e tyre kishin vlera përcaktuese në funksionimin metodik, pedagogjik dhe organizativ të arsimit shqip.

Austro-Hungaria në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare bëri që gjuha shqipe jo vetëm të bëhet gjuhë në shërbimin civil zyrtar, por edhe të mësohet në disa qytete, për njërën nga ato është shkruar në nr. 65 të gazetës "Vëllazënia" të Vjenës.

Shoqënia
e studentëve shqiptarë
ALBANIA
WIEN

SHOQËNIA E STUDENTËVE SHQIPTARË WIEN

Der Vereinspräsident.
Basho
VII. Burggasse 42/10

Vëllazënija No. 65 3

Shkolla shqype në Gjakovë.

Miqtë t'onë na dërguenë këtë fotografi të nxënësavet të shkollës shqype në Gjakovë, të cilën po ju qesim përpara me gëzim lexuesavet t'onë. Miqve të vegjël në Gjakovë po ju dërgojm shumë fatime e të fala! Rrofshin e qofshin me jetë të gjatë!

Shkolla Shqype në Gjakovë, të cilën po ju qesim përpara me gëzim lexuesavet t'onë. Miqve të vegjël në Gjakovë po ju dërgojmë shumë fatime e të fala! ("Vëllazënija", nr. 65)

Para një shekulli gazeta "Djalëria", NR. 17, viti 1917 shkruante: "Sikundër nuk mund të rrojë një njeri pa gjak, sikundër nuk mund të zhvillohen bimët pa Diell, ashtu edhe një popull pa një gjuhë të zhvilluar nuk mund të naltësohet".

Ky qëndrim kaq fisnik e parimor i treguar ndaj shqiptarëve u vazhdua me refugjatët e luftës (1999) para njëzet vjetëve kur Serbia ushtroi gjenocidin më barbar ndaj kombit shqiptar në Kosovë duke dëbuar me dhunë rreth tetëqind mijë qytetarë nga vatrat e tyre. Austria mori dhjetë mijë refugjatë nën përkujdesje, pesë mijë nga të cilët në Austri. Atyre u siguroi, veç të tjerash, edhe shkollimin në gjuhën amtare. Të gjithë studentëve shqiptarë shteti austriak u dha bursa, pa marrë parasysh kriteret në rrethana normale për bursa. Sipas shënimeve, diku rreth tetë milionë shiling (1.1 milion marka) u ndanë për studentët. Studentëve shqiptarë iu njihej diploma e viteve '90 nga Universiteti i Prishtinës, kur studentët e dëbuar nga auditorët e tyre mësonin në kushte të vështira lokaleve të ndryshme. Sot në universitetet në Vjenë, Grac, Linc, Insbruk të Austrisë studiojnë rreth dy mijë studentë shqiptarë nga të gjitha viset shqiptare. Tradita e emrave me famë në shkencën shqiptare të studiuesve në Austri vazhdon, mes të tjerësh, me emrin e prof. dr. Eqrem Zenelaj, prof. Neritan Ceka si dhe shumë emra ministrash në qeveritë e Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë.

Në vitet e fundit të ndërtimit dhe reformave shkollore në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, ekspertët austriakë ishin të pranishëm me projektet e tyre të shumta. Ministria e Mësimit e Austrisë ndihmoi në ndërtimin dhe meremetimin e shumë shkollave dhe institucioneve të tjera në Shqipëri dhe Kosovë. Koha e re e mësimit shqip në Austri dhe vende të tjera evropiane nuk mund të kalohet pa përmendur emrin e autorit, metodicientit e pedagogut nga Zvicra prof. dr. Basil Schader. Ai është albanologu nga hapësirat gjermanofolëse më aktiv i kohës sonë. Projektet e tij kapin fushën mësimore me 20 tekste për nxënësit shqiptarë në diasporë: fushën didaktike e metodike me dhjetëra tekste kushtuar problemit didaktik të mësimdhënies në diasporë; fushën e ndihmës materiale, disa shkolla të rinovuara dhe ndërtuara në Shqipëri nga buxheti i tij privat; fusha e mësimdhënies, ligjërata në shumë seminare e vendeve të ndryshme rreth gjuhës shqipe dhe mësimit të saj. Në Austri pa dyshim emër i respektuar sot është albanologu dr. Kurt Gostentschnigg, një hulumtues i pasionuar në gjuhësi e fusha të tjera të shkencave albanologjike, përkthyes i dhjetëra veprave të autorëve shqiptarë në gjuhën gjermane. Mendimtari, fotografi dhe shkrimtari i njohur austriak prof. Peter Paul Wiplinger, një aktivist i madh në mbrojtje të të drejtave të njeriut, i njohur po ashtu te shqiptarët me aktivitetin e tij në mbrojtje të të drejtës për ta pasur shqiptarët Universitetin e tyre në Tetovë, në demaskimin e komunizmit jugosllav i cili burgoste e torturonte shqiptarët dikur. I njohur me veprat e tij në fushën letrare edhe në gjuhën shqipe. Fatbardhësisht vargu i miqve të shqiptarëve sot është i madh, por edhe veprat e shqiptarëve për të mirën e kulturës, sportit dhe shkencës botërore është i gjatë.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE					
WEST HAM UNITED - LIVERPOOL	2-2	FROSINONE - LAZIO	X-2	CAGLIARI - ATALANTA	2,3+

Januzi, lojtari më i paguar në Kosovë

Ahmed Januzi është lojtari më i paguar në futbollin e Kosovës. Ish-sulmuesi kuqezi fiton rreth 50 mijë euro në vit. "Futbollistët e Kosovës kushtet më të mira i kanë në skuadrën e Llapit, pasi të ardhurat e tyre janë shumë të larta. Januzi dhe të tjerët paguan mbi 45 mijë euro në vit. Ish-sulmuesi i Shqipërisë është lojtari më i paguar në Kosovë", ka thënë Tahir Batatina, drejtor i Llapit

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 3 SHKURT - Futbollistët që angazhohen në futbollin e Kosovës prej pranimit në UEFA dhe FIFA kanë filluar të fitojnë më shumë nga loja më e popullarizuar në botë, futbolli. Ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë në futboll, Ahmed Januzi, është aktualisht lojtari më i paguar në futbollin e Kosovës. Lajmin e ka konfirmuar të dielën për "Epokën e re" drejtori i skuadrës së Llapit, Tahir Batatina. Sipas tij, futbollistët e skuadrës nga Podujeva i kanë kushtet dhe pagat më të mëdha në Kosovë, kurse sulmuesi që ka bërë karrierë edhe në Shqipëri dhe Ukrainë, Ahmed Januzi, i prin kësaj "valle", pasi fiton rreth 50 mijë euro në vit. "Futbollistët e Kosovës kushtet më të mira i kanë në skuadrën e Llapit, pasi të ardhurat e tyre janë shumë të larta. Januzi dhe të tjerët paguhen mbi 45 mijë euro në vit. Ish-sulmuesi i Shqipërisë është lojtari më i paguar në Kosovë", ka thënë Batatina, i cili me këtë rast konfirmoi se gjendja financiare në skuadrën që pretendon titullin e kampionit është mjaft e mirë. "Kjo tregon për gjendjen financiare në klubin tonë. Falë donatorëve të fuqishëm asnjëherë nuk kemi pasur krizë financiare, prandaj edhe lojtarët paguhen më së shumti në Kosovë", ka shtuar ai.

Sulmuesi Ahmed Januzi gjatë verës nga Prishtina u transferua te Llapi, duke regjistruar vetëm tri paraqitje për shkak të lëndimit. 30-vjeçari që ka bërë karrierë edhe në skuadrën e Besës së Kavajës dhe Vorskla Poltavae ka tejkaluar lëndimin dhe është i gatshëm për sezonin pranveror. Gazeta ka mësuar se paga të majme në skuadrën e Llapit marrin edhe Mentor Zhdrella, Behar Maliqi, Hamdi Namani e të tjerë. Skuadra e Llapit në sezonin vjeshtor kishte disa telashe, ku edhe u eliminua nga gara e Kupës, kurse kampionatin e mbylli në pozitën e tretë pas Feronikelit dhe Prishtinës. Në afatin kalimtar të janarit, me synim që ta ndjekë titullin kampion, Llapi ka angazhuar trajnerin Xhengis Rexhepi dhe ka transferuar nëntë futbollistë: Blendi Miftari, Flamur Bajrami, Elvis Prenqi, Miran Maksuti, Lorik Aliu, Rron Statovci, Remzi Selmani, Hajdin Salihu, Donik Osmani.

SHKURT

Ndahen mjetet për ngritjen e shtatores së Fadil Vokrrit

Deputetit Bekim Haxhiu iu miratua propozimi i amendamentit të 137 për ngritjen e shtatores së Fadil Vokrrit, me 47 vota për dhe 12 kundër. "Shtatorja e Fadil Vokrrit duhet të ndërtohet. Kërkoj votën tuaj. Ngritja e kësaj shtatore shkon 200 mijë euro", ka thënë Haxhiu. Ky amendament i takon Projektligjit për ndarjen buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019.

Sukses historik i Kosovës në futsall

Përfaqësuesja e Kosovës në futsall ka shënuar fitore edhe në duel me Andorrën në kuadër të parakualifikimeve për Kampionatin Botëror "Lituania 2020" në futsall dhe kësisoj e ka siguruar pjesëmarrjen në rrethin e ardhshëm kualifikues "Main Round". Pas fitores kundër Norvegjisë, djelmoshat e Ramadan Cimilit e mposhtën Andorën me rezultat 5-3, duke i mbyllur garat e Grupit B të parakualifikimeve në Minsk të Bjellorusisë me 6 pikë. Tre gola për Kosovën i shënoi Ramadan Alaj, kurse me nga një gol kontribuuan Oso Gjinovci dhe Dardan Topilla.

Trajneri i Reimsit lavdëron Zenelin

Trajneri i Stade de Reims, David Guion, e ka lavdëruar reprezentuesin e Kosovës, Arbër Zenelin, i cili ka debutuar për klubin e vet të ri. "Ne kemi bërë një transferim të së ardhmes. Zeneli bëri një javë me ne. Ai ishte në gjendje të përshtate me grupin dhe ka teknikë interesante", ka thënë Guion.

Ponte Prizreni fitoi derbin ndaj Bashkimit

Ponte Prizreni ka fituar në derbin lokal kundër Bashkimit të zhvilluar në palestrën "Sezai Surroi" me rezultat 83-75. Ponte, që kishte epitetin e mysafirit, i shënoi gjashtë pikë më shumë se kampioni në fuqi në çerekun e parë (17-23). Vetëm një pikë më shumë e shënoi në çerekun e dytë (19-20) skuadra e promovuar këtë edicion në Superligën e Kosovës në basketboll. Edhe çereku i tretë ishte shumë i përafërt (14-15), me vetëm një pikë diferencë ndërmjet dy ekipeve. Skuadrat luajtën baras deri në fraksion të fundit (25-25), porse Ponte e fitoi sfidën falë paraqitjeve në dhjetëminutëshat e tjerë.

Istogu ballëhapur eliminohet nga garat evropiane

PRISHTINË, 3 SHKURT - KHF Istogu është përshëndetur nga garat evropiane të edicionit aktual 2018\19. Skuadra e Istogut është ndalur në një të tetën e finales të Kupës Sfiduese (Challenge Cup) nga skuadra spanjolle Rincon Fertilidad Malaga. Ndeshja e dytë e hendbollisteve istogase me Malaganë është zhvilluar të dielën në Alhaurin de la Torre të Spanjës. Në këtë ndeshje lojtaret e Istogut janë mbajtur shumë më mirë se në ndeshjen e parë të luajtur të shtunën në mbrëmje, pasi ekipi spanjoll fitoi me rezultat 21:13. Ndërsa humbja e parë ishte me rezultat të thellë 40:9. Duhet cekur se deri pak minuta para fundit epërsia e spanjolleve ishte 4-5 gola. Te Istogu më efikasja ishte Elma Kameri me 8 gola. Istogu në Spanjë është paraqitur me fond të limituar lojtaresh për shkak se tri lojtare janë lënduar e një e ka ndërprerë karrierën.

Po ashtu, udhëtimi për në Spanjë ishte shumë i gjatë e me shumë pengesa dhe kjo bëri që lojtaret të ishin të lodhura, sidomos për ndeshjen e parë, ku edhe angazhimi nuk ishte ai i pritur. Edhe ndeshja e dytë është luajtur vetëm me flamur të EHF-së dhe të Kupës Sfiduese në palestër, që ishte kërkesë e Istogut, pasi spanjollët nuk lejuan flamurin e Kosovës, ndërsa kërkuan që flamuri i tyre të jetë në palestër. Edhe ky presion kishte ndikimin e vet. Malaga në përbërje i ka shtatë lojtare të vendeve të tjera dhe cilësi e përvojë dukshëm më të madhe

se Istogu. Me eliminimin e Istogut është mbyllur edicioni evropian për skuadrat kosovare, me shpresë që edicionin tjetër do të bëhet edhe ndonjë hap para.

Ronaldo: Do të jetë viti i madh i Juves

Torino, 3 shkurt - Pas humbjes me Atalantën, Juventusi u ndal nga Parma, duke pësuar tre gola. Cristiano Ronaldo realizoi dy herë, por nuk u mjaftoi bardhezinjve për t'i marrë pikët e plota nga ky takim. "Ky është futbolli. Jam i lumtur që zhvilluam një lojë të mirë, edhe pse në fund nuk arritëm dot që ta merrnim maksimumin nga ky takim. Skuadra zhvilloi një pjesë të parë mjaft të mirë. Kundërshtari shënoi vetëm nga pakujdesia dhe gabimet tona, duke mos na vënë seriozisht në rrezik. Nuk mund të them se rezultatet e fundit janë nga ngarkesa fizike, por vetëm nga disa gabime. Jam i bindur se do të përmirësohemi edhe më shumë dhe nuk shoh që të kemi ndonjë problem për t'u shqetësuar. Jam i sigurt se ky do të jetë viti i madh për Juventusin", ka thënë Ronaldo.

Klea Vrella: Synoj ta arrij rezultatin më të mirë të mundshëm

Prishtinë, 3 shkurt - Klea Vrella dhe Elba Kokaj janë dy skitaret e vetme që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore Evropiane për të Rinj (EYOF) që mbahen prej 9-16 shkurt në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore të Bosnjë e Hercegovinës. Klea është nga qyteti i Pejës. Ka lindur më 1 nëntor të vitit 2002, ndërsa që nga mosha shtatëvjeçare ka filluar të merret me sportin e skitarisë. "Prej se isha e vogël më ka pëlqyer skijimi dhe kam pasur qejf gjithmonë të merrem me këtë sport. Dashuria për skitë më ka lindur nga programet televizive", ka thënë Vrella në një intervistë për faqen zyrtare të Komitetit Olimpik të Kosovës. Ajo më parë është marrë edhe me not dhe tenis, por rrugën e suksesin e ka gjetur te sporti i dimrit. Klea është kampione e Kosovës për juniore të reja në disiplinën sllallom. Vitin e kaluar fitoi medaljen e artë në kampionatin e Kosovës për disiplinat sllallom dhe sllallom i madh. Në këto dy disiplina ajo do të garojë edhe në Sarajeva 2019. Në muajt e fundit, falë mbështetjes financiare nga Komiteti Olimpik i Kosovës, Klea dhe Elba janë përgatitur në Erzurum të Turqisë dhe në Brod të Dragashit, për t'i mbushur

"bateritë" për paraqitje sa më të mirë në EYOF Sarajeva 2019. "Kemi kaluar shumë mirë në përgatitje. Kushtet ishin shumë të mira", ka shtuar ajo.

Klea ka garuar në gara të ndryshme ndërkombëtare, por EYOF Sarajeva 2019 do të jetë e veçantë për të. "Ka qenë ëndërr e imja të marrë pjesë në EYOF", shprehet 16-vjeçarja, e cila shpalos edhe synimet për të ardhmen: "Synoj ta arrij rezultatin më të mirë të mundshëm, ndërsa në të ardhmen ëndërroj të përfaqësoj Kosovën edhe në Olimpiadën e Senioreve". Garuesja e klubit Alpi të Pejës frymëzimin për të garuar e gjënë tek idhulli i saj, dy herë kampionia e botës dhe një herë medalistja e artë olimpike, amerikania Lindsey Vonn. Për ekipin olimpik të Kosovës, EYOF-i dimëror Sarajeva 2019, do të jetë pjesëmarrja e dytë, pas debutimit në "Erzurum 2017".

Golden State mposhti Lakersat

Oakland, 3 shkurt - Skuadra kampione e Golden State ka fituar 115-101 ndaj Lakersave, në përballjen mes dy ekipeve pretendente për titull në Konferencën e Perëndimit. Një ndeshje me luhatje, ku Warriorsi dominoi në pjesën e parë, ndërsa në periodën e tretë ishin miqtë ata që udhëhiqnin në fushë. Por, gjithçka u vendos në minutat e fundit, ku u dalluan Thompsoni me 28 pikë e Duranti me 27, ndërsa Cousins e mbylli me 18 pikë e 10 rebounde. Mirë u paraqitën edhe lojtarët e stolit, nga ku erdhën 30 pikë. Te Lakersi u ndje shumë mungesa e LeBron Jamesit në stol, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Ingram me 20 pikë, ndërkohë që të pestë titullarët realizuan mbi 12 pikë. Me fitore replikon edhe Denveri, që mundi në sekondat e fundit 107-106 Minnesotan jashtë fushës dhe qëndron në vendin e dytë në Perëndim. Townsi realizoi 31 pikë e 12 rebounde për vendësit, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Denverin u dalluan Beasley me 22 pikë e Bartoni me 20 (Jokiq e mbylli me një "triple double", me 13 pikë, 16 rebounde e 10 asistime), raporton "Telesport". Nuk zhgënjen skuadra e Milwaukees, që triumfoi 131-115 në

fushën e Washingtonit, ndeshje ku diferencën në parket e bëri i zakonshmi Antetokounmpo, që realizoi 37 pikë e 10 rebounde. Fiton edhe skuadra e Indianas që, falë 31 pikëve të Bogdanoviçit, mundi 95-88 Miamin. Skuadra e San Antonios qëndron mes ekipeve më të mira pas fitores 113-108 ndaj New Orleansit. 6 lojtarë të Spursit realizuan mbi 10 pikë, me Aldridge që ishte shënuesi më i mirë, autor i 25 pikëve e 14 reboundeve. Vazhdon momenti i mirë i Houstonit, që mundi 125-98 Utah Jazzin në shtëpinë e këtij të fundit, ndeshje ku u dallua Hardeni që realizoi 43 pikë e 12 rebounde. Kjo është ndeshja e 26-të radhazi ku ai realizon mbi 30 pikë. Fitoi edhe Clippersi 111-101 ndaj Detroitit, me Lou Williamsin që realizoi 39 pikë.

REZULTATET

Detroit - Clippers	101-111
Charlotte - Chicago	125-118
Orlando - Brooklyn	102-89
Washington - Milwaukee	115-131
Cleveland - Dallas	98-111
Miami - Indiana	88-95
Golden State - Lakers	115-101
San Antonio - New Orleans	113-108
Minnesota - Denver	106-107
Phoenix - Atlanta	112-118
Utah Jazz - Houston	98-125
Sacramento - Philadelphia	115-108

SHKURT

Messi rrezikon ta humbasë "El Clasico"-n

Barcelona nuk arriti më shumë se një barazim 2-2 kundër Valencias në "Camp Nou". Leo Mesi shënoi dy gola duke barazuar avantazhin e dyfishtë të miqve, por ka pësuar një dëmtim në këtë ndeshje. Kapiteni është detyruar të largohet përpara kohës nga loja si pasojë e një dëmtimi në këmbën e djathtë. Ai është në dyshim për "El Classico"-n e së mërkurës për llogari të gjysmëfinales së parë të Kupës së Mbretit. Messi humbi edhe sfidën e kampionatit kundër Realit, por ky dëmtim është më i thjeshtë si i mëparshmi. Diçka e tillë konfirmohet edhe nga trajneri i Barcelonës, Ernesto Valverde. "Le të presim se çfarë do të thonë mjekët. Leo ndien pak dhimbje, por nuk duket ndonjë gjë e rëndë", ka thënë Valverde.

Dybala, probleme me Allegrin

Juventusi nuk ndodhet në një moment të mirë. Pas eliminimit nga Kupa e Italisë, bardhezinjtë barazuan edhe me Parmën. Situata duket e acaruar dhe këtë e ka shfaqur edhe Paulo Dybala në fundin e ndeshjes. Ai është parë i nervozuar me trajnerin për shkak të mosaktivizimit. Fillimisht u aktivizua Bernardeski, ndërsa ky i fundit dëmtohet në lojë, futet Emre Can dhe jo argjentinasi. Dybala është larguar nga stoli për në dhomat e zhveshjes ende pa përfunduar takimi. Trajneri Allegri e ka kaluar me një koment ironik ketë situatë. "Ndoshta kishte ftohtë dhe u largua më herët", ka thënë Allegri.

Courtoisi preferon Hazardin para Neymarit

Portieri i skuadrës Real Madrid, Thibaut Courtois, ka thënë se e preferon futbollistin Eden Hazard në vend të brazilianit Neymar. Është raportuar se Reali është i interesuar për belgun dhe brazilian. "Unë do ta zgjedhja Eden Hazardin, natyrisht. Më pëlqen vërtet, mirëpo zgjedhja i takon bordit", ka thënë Courtois.

Balotelli: Futbolli italian është pak i mërzitshëm

Mario Balotelli u transferua gjatë janarit te Marseille, ekip me të cilin gjeti golin në ndeshjen e parë. Sulmuesi italian është rikthyer të flasë për kampionatin italian dhe zbulon ekipin me të cilin dëshiron ta mbyllë karrierën. "Futbolli italian është shumë taktik dhe pak i mërzitshëm. Nuk kam menduar të kthehem në Serinë A gjatë këtyre muajve, por nuk e mohoj dot se do të më kishte pëlqyer ta mbyllja karrierën me Brescian", ka thënë sulmuesi 29-vjeçar.

Juve nuk e "harron" Pogban

Juventusi nuk ka hequr dorë nga transferimi i mesfushorit të Manchester Unitedit, Paul Pogba. 25-vjeçari francez gëzoi kohë të arta dhe të mbushura me trofe te "Bianconerët" më parë, duke fituar katër tituj të Serisë A në mesin e shumë trofeve të tjerë midis viteve 2012 dhe 2016. Mediumi britanik "The Express" raporton se, pavarësisht prej rizbulimit të formës së tij më të mirë nën drejtimin e Solskjaerit, Juventusi do të përpiqet ta nënshkruajë atë përsëri këtë verë. Çmimi i mesfushorit vazhdon të mbetet ende mbi 100 milionë euro, ndërsa vazhdon të pëlqehet edhe nga Real Madridi dhe Barcelona.



Autor: GAZMEND MORINA

I PAHIJSHËM, I NDYRË · KËNGËTARE E JONA · NJË LLOJ SHPATE ME DOREZË TË STOLISUR · SKLLAV I LIRUAR A FSHATAR I LIRË / NËNNDARJE E NJË LIGJI (shq.) · DY BASHKËTINGËLLORE

KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.) · SHUMË, TEJ MASE (krah.) · ELEMENT KIMIK / DJALLËZOR (hebr.) · QYMEZ · SPËRKAT ME UJË · ELEMENTI MË I LEHTË KIMIK · ZANORE

MUNDËSI SHQIPTAR ..... PRIZRENI / LLOJ REVOLEJE · KËNGËTARJA E FAMSHME BRAXTON · E BËJ ME DYSH A NË SHUMË PALË NJË PËLHURË / KËNGËTARJA .... NDOCI · DY BASHKËTINGËLLORE / SHKRONJA XVI · MAÇOKU / UGANDA, TAJVANI · IRIDIUM, AMPER / FUTBOLLISTI SHQIPTARE ARBELOA · LËNDË PLASËSE QË PËRDORET PËR TË MBUSHUR PREDHA · GRUP NJËRËZISH QË PËRBËJNË NJË KOMISION / E BIJA E KONTIT · LLOJ GAZI LUFTE / ISH POETI TURK MEHMET .... · KËNGËTARI ..... MAKASHI · ELEKTRODA E POLIT NEGATIV / ELEMENT KIMIK · AKTORJA & MODELJA ... HURLEY / TURK I VJETËR · KËNGËTAR I YNI · I KUFIZON · QYTET NË KOSOVË / MYANMAR AIRWAYS INTERNATIONAL · BASHKËT. / ARMENIA · KËNGËTARE E JONA · PËRKULJE NË NJËRËN ANË (sh.pashq.) / EMIRATES ISLAMIC BANK · AKTORJA E VJETËR ... RINA / TITULL OTOMAN · AKTORI I FAMSHËM .. PAÇINO / BËRTHAMOR · OLIVER KAHN / LASHTËSIA · I ÇMENDUR · INSTITUCION / ZIFT · NJË PREJ FIGURAVE STILISTIKE / RRAFSHNALTË E MADHE NË AZI · ZANORE / BANOR I NJË SHTET AZIATIK · BASHKËT. / BANOR I NJË QYTETI TONË · MOTOÇIKLETË (bised.) / MUZIKANTI KRASNIQI (shq.) · ZANORE · REGJISORI ILIR ..... / NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE · QYTET NË FRANCË / GAZ LUFTE QË SHKAKTON PLAGË NË LËKURË · "M" në mes të dy "O" / I SHKRIRË · VDEKJE · I LUHATSHËM NË QËNDRIME / ZANORE · SHPIRTI (Lat.) / BASHKËT. · AKTORJA E FAMSHME JESSICA .... · PRINCI ARAB · BASHKËT. · PJESË E ILIRISË / PËRFYTYRIM IDEAL I SHOQËRISË NJERËZORE · KËNGTARJA .... TARNER / I FUTE FLAKËN · LUMË I MADH NË HUNGARI · ELEMENT KIMIK (RU) / KËNGËTARJA .... BOKA · KANCELARJA GJERMANE ANGELA / OJNA · BASHKËT. · NJË (IT.) / I KAPËRDIJ · DESPOTIKE / PJESË E PORTIT DETAR · DY BASHKËTINGËLLORE / MODERATORE E NJOHUR SHQIPTARE · "R" pas dy "I" · LABOUR MARKET OPINION / IGLI TARE · EMËR MASHKULLI MYSLIMAN / DY ZANORE · PËREMËR VETOR / URAN, METËR · ZANORE / ISMET SYLEJMANI · LLOJ DRURI · I TRASH A I PRISH TEHUN / BASHKËT. · TË KËQIJA, PADREJTËSI QË BËN DIKUSH (shq.) / BASHKËT. · ZANORE · QYTET BREGDETAR NË TURQI · E FRIKËSOVE SHUMË DIKË

SUDOKU

					4	5		
3	5			1			4	
	6		2			8		
2	7				8	1		
		6				3		
		4	7				5	9
		3			9		1	
	4			2			8	5
		5	4					

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: K, BEJONS, ADALET, NITON, SATANIK, LAG, O, SAHIT, TONI, E PALOS, TP, DACI, IRA, TRITOL, JURI, SARIN, REDON, KATODA, LIZ, I LIMITON, GJAKOVA, B, GILI, ANIME, ITA, AL, OK, ENT, ANAFORA, E, ANTIKITETI, G, MOTOR, O, KABASHI, KANA, OMO, MORT, LABIL, ANIMA, EMIRI, EPIRI, TINA, TISA, RUTEN, MERKEL, R, UNO, TIRANIKE, ZB, IIR, LMO, ISA, ATA, A, AH, I TOPIT, ZULLUMI, ANTALIA, LEMERISE.

ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona I:798 634 521; KII:352 817 946; KIII:461 295 837; KIV:279 358 164; KV:516 942 378; KVI:834 761 259; KVII:683 579 412; KVIII:947 123 685; KIX:125 486 793.

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

SHPALL
KONKURS

Në bazë të nenit 12, paragrafi 4 i Ligjit për Shërbimin civil nr.03/L-149, bazuar në nevojën për funksionim dhe realizim të detyrave dhe obligimeve, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), shpall konkurs "Marrëveshje për shërbime të veçanta" për kandidatët e interesuar dhe të kualifikuar për vendin e punës:

Titulli: **Zyrtar për webfaqe të AKK**

Departamenti: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Koeficienti: 7
Kontrata: Jo i karrierës
Orari: i plotë (40 orë në javë)
I raporton: Drejtorit

Detyrat e punës:

1. Mirëmbajtja i webfaqes së AKK; www.akk-ks.net, domen dhe hosting;
2. Publikimi dhe përditësimi i materialeve të AKK;
3. Publikimi i fotove dhe produkteve tjera me interes për institucionin;
4. Konvertimi i dokumenteve në PDF dhe publikimi i tyre online ne webfaqe dhe rrjete sociale;
5. Trajnime për WEB për stafin e AKK sipas nevojës;
6. Kompaktibiliteti i WEB me browser të ndryshëm dhe mirëmbajtja e kodit duke e ruajtur funksionin;
7. Arkivimin e rregullt të të dhënave në bazën e të dhënave (databazë) dhe dosje fizike;
8. Ndryshimi i vegzave dhe linçeve sipas nevojës për palët e interesit;
9. Raportimin e rregullt dhe periodik për rezultatet dhe problemet eventuale në funksionimin të webfaqes së AAK-së.

Shkathtësitë e kërkuara: (*Kualifikimet, përvojat dhe aftësitë tjera)*

- Diplomë universitare në fushën e IT, 3 vite përvoje pune profesionale.
- Shkathtësi komunikimi me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe (e dëshirueshme njohja e gjuhës serbe dhe angleze)
- Aftësi për ta kuptuar informacionin e ndërlikuar dhe transmetuar të tjerëve;
- Aftësi për të krijuar raporte të mira me të tjerët
- Gatishmëri për punë ekipore;
- Bashkëpunim në zgjidhjen e probleme në situate të caktuara;
- Shkathtësi për punë me kompjuter dhe njohje të teknologjisë së informacionit (IT);
- Gatishmëri për punë nën presion
- Respektim të legjislacionit dhe detyrave në vendin e punës

Shërbimi Civil i Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës.
Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e pakompletuara apo të dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Aplikacioni për konkurrim(formulari) mund ta merret dhe dorëzohet në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, Adresa: Rr. "Agim Ramadani" nr. 26, Qendra e Studentëve (zyra e administratës).

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 7 ditë nga dita e shpalljes së konkursit (11.02.2019).

Me rastin e aplikimit kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- ***Diplomën e shkollimit (e vërtetuar te noteri)***
- ***Nëse diploma është e fituar jashtë vendit të jetë e nostrifikuar***
- ***Vërtetim mbi përvojën e punës dhe pasqyra nga trusti pensional***
- ***Certifikatë që nuk jeni nën hetime***
- ***Dokumentin e identifikimit***

Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

OBJAVLJUJE
KONKURS

Na osnovu član 12, stav 4 Zakona o civilnoj službi br. 03 / L-149, shodno potrebi za funkcionisanje i izvršavanje dužnosti i obaveza, Nacionalni autoritet za kvalifikacije (NAK) objavljuje "Ugovor o posebnim uslugama" za zainteresovane i kvalifikovane kandidate za radno mesto:

Zvanje: **Službenik web stranice KAA**

Departament: Nacionalni autoritet za kvalifikacije
Koeficijent: 7
Ugovor: Ne u karijeri
Radno vreme: puno (40 sati nedeljno)
Izveštava: Direktora

Zadaci i odgovornosti:

1. Održavanje web stranice KAA-a; www.akk-ks.net, domena i hosting;
2. Objavljivanje i ažuriranje materijala NAK-a;
3. Objavljivanje slika i drugih proizvoda od interesa za instituciju;
4. Konvertiranje dokumenata u PDF i njihovo online objavljivanje na internetu i na društvenim mrežama;
5. Obuka za WEB osoblja KAA-a po potrebi;
6. Kompatibilnost WEB-a sa različitim pretraživačima i održavanjem koda uz očuvanje funkcije;
7. Redovno arhiviranje slanje podataka u bazu podataka (databazi) i fizičke dosije;
8. Promena linkova prema potrebi za interesiranim stranama;
9. Redovno i periodično izvještavanje o rezultatima i eventualnim problemima u funkcionisanju web stranice KAA.

Potrebne veštine: (*Kvalifikacije,iskustvo i druge sposobnosti)*

- Univerzitetska diploma iz oblasti IT, 3 godine profesionalnog radnog iskustva.
- Pismene i usmene veštine komunikacije na albanskom jeziku (poželjno poznavanje srpskog i engleskog jezika)
- Sposobnost razumevanja složenih informacija i prenošenja drugima;
- Sposobnost stvaranja dobrih odnosa s drugima
- Spremnost za timski rad;
- Saradnja u rješavanju problema u određenim situacijama;
- Veštine za rad na računaru i prepoznavanje informacione tehnologije (IT);
- Spreman za rad pod pritiskom
- Poštivanje zakona i dužnosti na radnom mestu

Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave žena i muškaraca svih zajednica na Kosovu.
Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe u centralnoj i lokalnoj javnoj administraciji, kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova

Ne kompletirana dokumenta ili dostavljena nakon isteka roka neće se razmatrti.

Aplikacija za prijavu (obrazac) može se dobiti i dostaviti Nacionalnom autoritetu za kvalifikacije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 26, Studentski centar (kancelarija administracije).

Krajni rok za podnošenje prijava je 7 dana od dana objavljivanja konkursa (11.02.2019.).

Prilikom prijave kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- ***Diploma o obrazovanju (overen od strane notera)***
- ***Ako je diploma stečena u inostranstvu, treba biti nostrifikovana***
- ***Potvrda o radnom iskustvu i finansijski izveštaj iz Penzionog trusta***
- ***Potvrda da niste pod istragom***
- ***Identifikacioni dokument***

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

Institucioni : Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall konkurs për këtë pozitë:

KONKURS

Titulli i punës : Zyrtar Ligjor 2
Nr.ref. RP00082006
Kategoria funksionale : Niveli Profesional
Koeficienti : 7
Lloji i pozitës : I karrierës
Orët e punës : 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: 1 vitë periudha provuese
Vendi i punës : Prishtinë
Mbikëqyrës: Drejtori të Departamentit Ligjor/Licencim

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave profesionale në fushën e hartimit të politikave dhe legjislacionit nga fushëveprimi i institucionit

Detyrat Kryesore

- Përgatitja e draft rregulloreve dhe udhëzimeve sipas nevojave të ARH-s, bazuar në Rregulloret dhe Direktivat e BE-se;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në gjuhët zyrtare;
- Ndihmon në përgatitjen e opinione ligjore si dhe hartimin e projektmarrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
- Bashkëpunon me njësitë tjera brenda ARH-s për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
- Përgatitja e politikave rreth aspekteve të ndryshme të rregullimit të transportit hekurudhor;
- Përgatitja e shkresave të ndryshme ligjore dhe draft vendimeve që i ndërmerr ARH-ja si dhe shkresave tjera që ndërlidhen me ARH-në;
- Përgatitja e shkresave administrativo-juridike për gjykata si dhe përfaqësimi i ARH-se në kontestet gjyqësore sipas autorizimit;
- Kryen dhe pune te tjera qe i caktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Shkathtësitë e kërkuara

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik , Bachelor/Jurist i Diplomuar
- 2 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Adresa: Rr. Rrustem Statovci Nr 29 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në ueb faqen zyrtare www.arh-ks.org

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurroni.

"Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."
"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtaret e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".
"Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen". Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurroni. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority

Institucija: Regulativni Autoritet Železnica

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo, br. 03/L - 149 i Uredbe br. 02/2010 o proceduri zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosovo, Regulativni autoritet železnica objavljuje konkurs za ova radna mesta:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Pravni službenik 2
Ref. br. RP00082006
Funkcionalna kategorija: Stručni nivo
Koeficijent : 7
Vrsta pozicije: Karijerna
Radno vreme: 40 časova nedeljno
Trajanje imenovanja: 1 godina probnog perioda
Radno mesto: Priština
Nadzornik: Direktor Pravnog Odeljenja/za Licenciranje

Svrha radnog mesta: Pružanje stručnih usluga i savjeta u oblasti izrade politika i zakonodavstva iz djelokruga institucije

Glavne dužnosti

- Priprema nacrta propisa i smjernica u skladu sa potrebama RAŽ, na osnovu propisa i direktiva EU;
- That Obezbeduje da su sadržaj i forma nacrta normativnih akata tačni, lingvistički i tehnički, i da su identični na službenim jezicima;
- In Pomaže u pripremi pravnih mišljenja i izradi nacrta rezolucija, nacrta odluka i drugih nacrta akata;
- Suraduje sa drugim jedinicama unutar RAŽ za aktivnosti koje se odnose na oblast zakonodavstva;
- Pripremiti politike o različitim aspektima regulacije željezničkog saobraćaja;
- Pripremiti različite pravne dokumente i nacrte odluka koje je preduzela RAŽ i druga povezana dokumenta RAŽ;
- Priprema administrativno-pravnih dokumenata za sudove kao i zastupanje RAŽ u sudskim sporovima po ovlašćenju;
- Vrši i druge poslove određene od direktnog nadzornika

Potrebne veštine

- Univerzitetska diploma, Pravni fakultet
- 2 godine profesionalnog iskustva
- Duboka i specijalizovana znanja iz oblasti zakonodavstva i izrade pravnih akata
- Poznavanje važećih zakona i propisa
- Vještina u planiranju komunikacija funkcioniše eventualnu koordinaciju osoblja na administrativnom nivou;
- Istraživačke, analitičke, evaluacijske vještine i formuliranje preporuka i stručnih savjeta;
- Računarske veštine u programskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Internet).

Preuzimanje i dostavljanje aplikacija:

Aplikacije se preuzimaju i dostavljaju u Kancelarijama Regulativnog Autoriteta Železnica, Adresa: Ul. Rrustem Statovci Br. 29 Priština, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Aplikacija se može preuzeti i na službenoj veb stranici www.arh-ks.org

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja konkursa.

Aplikaciji treba priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koja se zahteva za ovo radno mesto za koje konkurišete.

"Civilna služba Kosova služba pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svih građana Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu."
"Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravednu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe javne uprave na centralnom i lokalnom nivou kao što je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona Br. 03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosovo".

"Aplikacije dostavljene nakon predviđenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene". Aplikaciji treba priložiti kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i ostalu potrebnu dokumentaciju koja se zahteva za ovo radno mesto za koje konkurišete. Samo kandidati odabrani na užem spisku biće kontaktirani.

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Më 03.02.2019 u bënë 3 vjet e 1 muaj e 7 ditë nga vdekja e nënës tonë (28.12.2015)

Mihrije Morina

1934-2015

Dje janë bërë 3 vite nga vdekja e Nënës , gjyshes sonë të dashur. Jemi krenar që të patëm të tillë.

Të përkujtojmë me mall: djali Ramizi nipi Shqiptari Mbesa Erëblina si dhe farefisi Morina.

Më 03.02.2019 u bënë 3 vite e 5 muaj (01.09.2015) nga vdekja e Babait tonë të dashur

Rasim Morina

1932-2015

Më 03.02.2019 u bënë 3 vite e 5 muaj (01.09.2015) nga vdekja e Babait dhe gjyshit tonë të dashur. Do të jetojmë me dhimbje që të humbëm por krenar që të patëm.

Të përkujtojnë: djali Ramizi nipi Shqiptari dhe mbesa Erëblina si dhe farefisi Morina nga Prizreni.

Veterane (ILEGALËS) dhe UÇK



Dje më 03.02.2019 u bënë 4 vite pa më të dashurën tonë

Hatije Morina

Veterane e (ILEGALES) dhe UÇK-së

1972-2015

U bënë 4 vite nga vdekja e më të dashurës tonë. Askush nga ne nuk mund të paramendoj më tejë jetën pa ty. Mirëpo ky rrugëtim i jetesë sonë është përplot dhembje dhe mall që gjithmonë ishe dhe do mbetesh udhërrëfim për ne.

Të përkujtojmë me mall: bashkëshorti Ramizi, djali Shqiptari, vajza Erëblina si dhe farefisi Morina.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ "Paper Communications" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70549557 nr. Fis. 600328779 si dhe nr. TVSH-së, 330066250.

▶ "Paper Media" SH.P.K. shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70988550 nr. Fis.601016430 si dhe nr. TVSH-së, 330210435.

▶ Dyqani i Pavarur Tregtar "Bleri" shpallë të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me nr. 80261187

▶ Driton Beqiri shpallë të pavlefshme dëftesën e SHFMU " Rexhep Musa " Vushtrri

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905

AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333